# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5505
E mërkurë, 20 qershor 2018
çmimi 0.40 €


## Limaj nderohet me mirënjohje nga "Çamëria"



Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, është nderuar të martën me mirënjohje nga shoqata "Çamëria". Me këtë rast Limaj ka thënë se ndarja e kësaj mirënjohje është nder i madh për të FAQE 5


Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", LISEN BASHKURTI FAQE 4-5

# Marrëveshja Kosovë - Serbi do të jetë komplekse



Diplomati i njohur, presidenti i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Lisen Bashkurti, ka ftuar lidershipin e Kosovës të përgatitet për fazën finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është e nevojshme që ky proces parapërgatitor të jetë serioz, legjitim, i përgjegjshëm, transparent dhe gjithëpërfshirës. Ai ka theksuar se në tërësi bisedimet Kosovë -Serbi deri më tani kanë krijuar më shumë zhgënjime sesa shpresa afrimi, pajtimi dhe bashkëpunimi. Bashkurti ka thënë se procesi i bisedimeve Kosovë - Serbi ka ngelur në status quo. "Ose, më saktë, në një rreth të mbyllur pa rrugëdalje", ka thënë ai. Diplomati Bashkurti ka thënë se lideshipet e këtyre dy shteteve nuk po kanë energji të mjaftueshme për të dalë vetë nga ky rreth i mbyllur. Ai ka kërkuar më tepër energji nxitëse nga BE-ja dhe më shumë mbështetje nga ShBA-ja

## Hoxha kërkon unitet për zbatimin e MSA-së



Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë të martën para deputetëve, se Qeveria ka bërë hapa shumë të rëndësishëm për konsolidimin e planifikimit dhe zbatimit të politikave nacionale për zbatimin e MSA-së. Ajo ka thënë se zbatimi i MSA-së nuk është agjendë partiake, por agjendë shtetërore. Ministrja Hoxha ka theksuar se asnjë projektligj, reformë apo proces tjetër nuk bën të ngecë për shkak të mospajtimeve politike e partiake FAQE 3



## Bytyqi: Angazhimi i përbashkët krijon mundësi për arsim cilësor

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, gjatë tryezës me temën "Prioritetet në fushën e arsimit parauniversitar", ka theksuar se vetëm angazhimi i përbashkët krijon mundësi për arsim cilësor në Kosovë FAQE 6

### AKTUALE


ËNDRRA DUHET TA PAGUAJË TAGRIN E VET F. 13



Bedri Zenel ISLAMI

HASHIMI, JUL CEZARI I KOSOVËS; BEKIMI, KUASIMODO I HASHIMIT! F. 11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

SBASHK-U EDHE KËTË VIT DËRGON NË PUSHIME 425 PUNËTORË TË ARSIMIT F. 6


### EKONOMI


GËRXHALIU: KOSOVA URGJENTISHT DUHET TË APLIKOJË PËR ANËTARËSIM NË OBT F. 8

IPKO-ja MBYLL KODIN E TELEFONISË FIKSE +381 F. 8


### KULTURË


DREJT HAPJES SË MUZEUT ME VEPRAT E ARTISTIT IBRAHIM KODRA F. 8


### SPORT


MBAHEN KONSULTIME ME KLUBET E FEMRAVE PËR REFORMIMIN E LIGËS F. 18

SA ËSHTË I SIGURT BOTËRORI 'RUSIA 2018'? F. 19



RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të martën në takim zëvendëskryeministrin e Maqedonisë, Bujar Osmani

# Thaçi: Marrëveshja Greqi - Maqedoni krijon klimë të mirë rajonale

Në takim me zëvendëskryeministrin e Maqedonisë, Bujar Osmani, për arritjen e Marrëveshjes midis Greqisë dhe Maqedonisë lidhur me emrin e ri të shtetit fqinj, presidenti Thaçi ka thënë se çdo lajm i mirë nga Maqedonia është lajm i mirë edhe për Kosovën dhe krijon klimë të mirë rajonale dhe hap perspektivë euroatlantike për shtetet e Ballkanit



PRISHTINË, 19 QERSHOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të martën në takim zëvendëskryeministrin e Maqedonisë, Bujar Osmani. Me rastin e arritjes së Marrëveshjes midis Greqisë dhe Maqedonisë lidhur me emrin e ri të shtetit fqinj, presidenti Thaçi ka thënë se çdo lajm i mirë nga Maqedonia është lajm i mirë edhe për Kosovën. "Kjo marrëveshje krijon klimë të mirë rajonale dhe hap perspektivë euroatlantike për shtetet e Ballkanit", është shprehur presidenti Thaçi.
Presidenti Thaçi dhe zëvendëskryeministri Osmani kanë biseduar edhe për zhvillimet aktuale në Maqedoni, ku forcat politike shqiptare po luajnë rol pozitiv rreth avancimit të të drejtave politike dhe sociale. Marrëveshja midis Greqisë dhe Maqedonisë konsiderohet më e rëndësishmja pas asaj të Ohrit.
Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka pritur të martën në takim zyrtar homologun e tij nga Maqedonia, Bujar Osmani.
Hoxhaj dhe Osmani kanë diskutuar në lidhje me marrëveshjen për emrin, e cila është arritur fundjavën që lamë pas në mes të Shkupit dhe Athinës, duke i dhënë fund mosmarrëveshjes disavjeçare.
Hoxhaj ka thënë se arritja e kësaj marrëveshjeje është lajm i mirë jo vetëm për Maqedoninë, por edhe për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, pasi që përbënë mbylljen e njërës nga çështjet më të rëndësishme të Ballkanit. "E urova zëvendëskryeministrin Osmani për nënshkrimin e marrëveshjes për emrin, duke krijuar momentum të ri në Ballkan për zgjidhjen e çështjeve të hapura historike", ka thënë Hoxhaj.
Në takim është diskutuar edhe për mbledhjen e përbashkët me Maqedoninë, nga e cila pritet të dalin mbi 15 marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara. Është bërë me dije se shumë shpejt pritet edhe caktimi i datës së kësaj mbledhje.

# Pacolli kërkon mbështetjen e Austrisë për liberalizimin e vizave



PRISHTINË, 19 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka nisur turneun diplomatik në disa vende evropiane në përpjekje për ta rritur mbështetjen për përshpejtimin e procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës si dhe anëtarësimin e vendit në organizata ndërkombëtare.
Vjena ishte ndalesa e parë e kryediplomatit Pacolli, ku ai u prit në një takim nga homologia austriake, ministrja e Austrisë për Çështje Evropiane dhe Punë të Jashtme, Karin Kneissel.
Në kuadër të këtij takimi dypalësh është vlerësuar bashkëpunimi i shkëlqyeshëm në mes dy vendeve, ndërsa është theksuar edhe miqësia historike në mes dy popujve, thuhet në njoftimin e MPJ-së. "Ne shikojmë përpara te Presidenca austriake e Këshillit Evropian dhe rolin tuaj, që ta sillni Ballkanin Perëndimor brenda agjendës së BE-së; në veçanti në lidhje me liberalizimin e vizave dhe shpresojmë se BE-ja do të marrë një vendim gjatë Presidencës suaj", ka thënë ministri Pacolli. Ai ka vlerësuar faktin që shteti austriak është partner kryesor dhe një nga investitorët më të mëdhenj në vendin tonë, përderisa ka shprehur zotimin se prania ekonomike austriake në Kosovë është shumë e mirëpritur.
Në vazhdim, ai i ka shprehur mirënjohje të thellë homologes austriake për mbështetjen e deritanishme të anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare, duke i kërkuar që kjo përkrahje të vazhdojë edhe më tutje, në veçanti me anëtarësimin e Kosovës në Interpol.
Pas vizitës dhe takimeve të nivelit të lartë në Austri, shefi i diplomacisë së Kosovës, Pacolli, do ta vazhdojë vizitën e parë zyrtare në Mbretërinë e Holandës dhe më pas me vizita të tjera.

## Meta: Diplomacia të jetë larg ndikimit të politikës



TIRANË, 19 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, tha se politika e jashtme e Shqipërisë duhet të jetë larg ndikimit të interesave të politikës së ditës. Deklarata e tij u bë gjatë një takimi që kreu i shtetit pati me Këshillin e Ambasadorëve Shqiptarë, të kryesuar nga presidenti i këtij Këshilli, ish-ministri i Punëve të Jashtme, Besnik Mustafaj.
Qëllimi i këtij takimi ishte njohja me misionin dhe programin e kësaj organizate, të themeluar nga një grup ish-ambasadorësh të Republikës së Shqipërisë si dhe bashkëpunimi me institucionin e Presidencës, në funksion të politikës së jashtme të Shqipërisë.
Krijimi i këtij Këshilli, tha presidenti Meta, është një nismë e vyer e cila do të ndihmojë me kontributin, përvojën dhe këshillat profesionale, në çështje të rëndësishme të politikes së jashtme.
Prania gjithëpërfshirëse e shumë personaliteteve të diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare është garanci për afirmimin e Këshillit të Ambasadorëve si një forum i pavarur dhe i orientuar nga interesat kombëtare. Presidenti u shpreh se politika jonë e jashtme duhet të jetë larg ndikimit të interesave të politikës së ditës, e maturuar dhe e përqendruar në interesat e qëndrueshme kombëtare, si dhe të ndërtohet mbi besueshmërinë afatgjatë ndaj aleatëve dhe partnerëve tanë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Hoxha kërkon unitet për zbatimin e MSA-së

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë të martën para deputetëve, se Qeveria ka bërë hapa shumë të rëndësishëm për konsolidimin e planifikimit dhe zbatimit të politikave nacionale për zbatimin e MSA-së. Ajo ka thënë se zbatimi i MSA-së nuk është agjendë partiake, por agjendë shtetërore. Ministrja Hoxha ka theksuar se asnjë projektligj, reformë apo proces tjetër nuk bën të ngecë për shkak të mospajtimeve politike e partiake



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të martën seancë, e cila ishte e thirrur për interpelancë nga grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) rreth zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) për tremujorin e fundit 2017 dhe tremujorin e parë të vitit 2018. Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se procesi i integrimit evropian është karakterizuar me një dinamikë progresive në vitet e fundit. Hoxha ka theksuar se Qeveria ka bërë hapa shumë të rëndësishëm për konsolidimin e planifikimit dhe zbatimit të politikave nacionale për zbatimin e MSA-së. Ajo ka thënë se fokusi ka qenë në planifikimin dhe zbatimin e dy dokumenteve nacionale për zbatimin e MSA-së: Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. "Plani i Veprimit për ERA parasheh zbatimin deri në fund të këtij viti të rreth 130 reformave strategjike të rëndësisë më të lartë politike për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së. Në vijim të përmbushjes së këtyre prioriteteve, më 10 nëntor 2017 Qeveria miratoi dokumentin 'Prioritetet kyçe të agjendës evropiane për vitin 2018', i cili parasheh zbatimin deri në fund të vitit 2018. Zbatimi i prioriteteve të ERA-s është përshpejtuar me marrjen e detyrës së Qeverisë së re", ka thënë ministrja Hoxha.?Sa i përket qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, ajo ka bërë me dije se së shpejti do të miratohet pakoja e ligjeve kornizë, e cila do të krijojë administratë publike efektive, meritokratike dhe në shërbim të qytetarëve.?

Sa i përket Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, ajo ka theksuar se Ministria e Integrimit rregullisht harton raporte tremujore për zbatimin e tij si dhe të njëjtat i raporton në Qeveri. Hoxha ka kërkuar vëmendjen e të gjitha institucioneve për përshpejtimin e reformave për zbatimin e masave të specifikuara në PKZMSA. "Raportet japin një pasqyrë sasiore të zbatimit të masave gjatë periudhës raportuese në nivel të programit në tërësi, të secilit bllok dhe të secilit kapitull, japin një vlerësim cilësor të gjendjes në çdo kapitull, duke përmbledhur sfidat kryesore në zbatim dhe ato të mundshme gjatë pjesës së mbetur të vitit, duke theksuar çështjet që kërkojnë vëmendje të veçantë në nivel të lartë politik", është shprehur ajo, duke theksuar synimet e shkallës së zbatimit prej 60 % në 2018-n. "Me theks të veçantë duhet të fokusohemi në fuqizimin e zbatimit të ligjeve, implementimin e reformës së administratës publike, avancimin e politikave të punësimit dhe arsimit, vazhdimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit", ka thënë ministrja Hoxha.

Ajo ka shtuar se disa herë ka insistuar në krijimin e një konsensusi nacional për reformat dhe proceset që janë pjesë e rrugës sonë drejt integrimit, sidomos masave që janë pjesë e PKZMSA-së. Hoxha ka theksuar se asnjë projektligj, reformë apo proces tjetër nuk bën të ngecë për shkak të mospajtimeve politike e partiake. "Zbatimi i MSA-së nuk është agjendë partiake, por agjendë shtetërore. Nuk është diçka për të cilën duhet të angazhohet vetëm Qeveria, por të angazhohen të gjitha institucionet dhe sigurisht duhet përkrahja edhe e opozitës, sidomos kur kemi të bëjmë me masat legjislative", ka thënë ministrja Hoxha, duke ofruar në dispozicion që të ndaj me deputetët të gjitha raportet që ka ministria, me qëllim të punës së përbashkët për t'i adresuar sfidat në këtë proces aq të rëndësishëm për vendin.

Ndërkaq partitë opozitare kanë theksuar se Qeveria ka treguar joseriozitet për zbatimin e MSA-së. Avdullah Hoti, shef i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka thënë se ka vonesa serioze për realizmin e 60 për qind të masave që lidhen me kriteret politike dhe 53 për qind të masave që lidhen me kriteret ekonomike. Sipas tij, ka ngecje në parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizimit dhe krimeve financiare. Kurse deputetja Fitore Pacolli nga Lëvizja Vetëvendosje ka thënë se Qeveria ka dështuar në realizmin e masave të planifikuara për zbatimin e MSA-së.

# Maliqi: Serbia po kërkon pretekst për ndërprerjen e dialogut



PRISHTINË, 19 QERSHOR - Publicisti Shkëlzen Maliqi ka treguar për gazetën "Epoka e re" arsyet pse i është ndaluar të martën hyrja në Serbi. Arsyeja e vetme të cilën ia kanë dhënë autoritetet serbe ka qenë përfshirja e tij në listën e personave që nuk mund ta kalojnë kufirin pa u verifikuar. Dhe e gjithë kjo procedurë, sipas tyre, mund të zgjaste tërë paraditen. "Më ndaluan në kufi në orën 5:00. Nuk më dhanë asnjë arsye. Thanë mund ta presësh verifikimin sepse emri yt është në listë të atyre që nuk mund të kalojnë pa verifikim. Kur u interesova sa zgjatë kjo, policët thanë ndodh tanë paraditen. Thjesht, maltretim. Ne ishim katër veta që udhëtonim për një tryezë sonte në Qendrën për Dekontaminim Kulturor me rastin e përvjetorit të ekspozitës 'Pertej 1 *1997' dhe botimit të librit 'Peter', studim i rastit, ku do të bisedonim për raportet kulturore Kosovë - Serbi. Me mua ishin edhe Jeton Neziraj, Besa Luci e Kosova 2/0 dhe Majlinda Hoxha, fotografe. Ata i lejonin të shkonin, por u solidarizuan me mua dhe në shenjë proteste u kthyen në Prishtinë", është shprehur Maliqi. Sipas Maliqit, këto sjellje të autoriteteve serbe janë pretekst për ta ndërprerë dialogun në të gjitha nivelet. "Mendoj se ata po kërkojnë pretekst për ndërprerjen e dialogut në të gjitha nivelet, edhe atë të shoqërisë civile. Po e kuptojnë se ky format i dialogut nuk ua plotëson dëshirën që ta ndajnë Kosovën dhe investojnë në prishjen e lojës, që procesi të kthehet në një pikë zero", ka deklaruar Maliqi.

Flet për "Epokën e re", Lisen Bashkurti

# Marrëveshja Kosovë - Se

Diplomati i njohur, presidenti i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Lisen Bashkurti, ka ftuar lidershipin e Kosovës të përgatitet për fazën finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se është e nevojshme që ky proces parapërgatitor të jetë serioz, legjitim, i përgjegjshëm, transparent dhe gjithëpërfshirës. Ai ka theksuar se në tërësi bisedimet Kosovë -Serbi deri më tani kanë krijuar më shumë zhgënjime sesa shpresa afrimi, pajtimi dhe bashkëpunimi. Bashkurti ka thënë se procesi i bisedimeve Kosovë - Serbi ka ngelur në status quo. "Ose, më saktë, ka ngelur në një rreth të mbyllur pa rrugëdalje", ka thënë ai. Diplomati Bashkurti ka thënë se lideshipet e këtyre dy shteteve nuk po kanë energji të mjaftueshme për të dalë vetë nga ky rreth i mbyllur. Ai ka kërkuar më tepër energji nxitëse nga BE-ja dhe më shumë mbështetje nga ShBA-ja



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 19 QERSHOR - "Epoka e re": *Z. Bashkurti, më në fund Greqia dhe Maqedonia arritën një marrëveshje historike rreth emrit të kësaj të fundit. Cila është rëndësia e kësaj marrëveshjeje për dy vendet dhe për Ballkanin në përgjithësi?*

**Bashkurti:** Prej më shumë se dy dekada Greqia ka bllokuar procesin e integrimit të Maqedonisë në NATO dhe BE për shkak të debatit për emrin. Më në fund zgjidhja erdhi. Negociatat e shumta e mjaft kontroverse përfunduan me emrin 'Republika e Maqedonisë Veriore". Është një përcaktim me nocion etno-gjeografik. Procesi i vështirë i debateve duket se ka qenë rreth nocionit që do të formulohej emri i ri. Ka pasur dy grup-propozimesh: një grup emrash me nocione historike dhe një grup emrash me nocione gjeografike. Emrat me nocione historike nuk u pranuan sepse kanë bartur ngarkesa etno-historike-kulturore me shumë ambiguitete, të papranueshme kryesisht nga pala greke. Emrat me nocione thjesht gjeografike kanë zbehur deri në fshirje identitetin etno-historik-kulturor dhe si të tillë janë hedhur poshtë gjatë bisedimeve nga pala maqedonase. Zgjidhja e negociuar erdhi si rezultat i kompromisit midis dy grup emrash, të atyre historikë dhe gjeografikë së bashku. Ky emër kompromisi duket se kënaqë më së shumti të dyja palët: pala maqedonase ndien të realizuar identitetin historik-kulturor (në pjesën e emrit 'e Maqedonisë'), ndërsa pala greke ndihet e kënaqur sepse ka arritur ta ruajë identitetin antik të Maqedonisë, duke e lokalizuar gjeografikisht (në pjesën e emrit 'Veriore').

Në negociata të dyja palët kanë lëshuar diçka nga vetja për t'ia dhënë palës tjetër, sikundër kanë fituar diçka për vete duke ia kufizuar palës tjetër. Zgjidhja duket të jetë e arsyeshme. Tipike formulë negociatash, ku asnjëra palë nuk fiton gjithçka, por edhe nuk humbet gjithçka. Është një rezultat win-win. Ose një fitore pa të humbur. Edhe nga përvoja historike e diskurseve politiko-diplomatike për emrat e shteteve praktika e përcaktimeve etnike e mpleksur me nocione gjeografike ka qenë më e gjendur, më e pranueshme dhe, si rrjedhoje, më e qëndrueshme. Kështu kemi emrat e Koresë së Veriut, të Timorit Lindor etj., që janë përdorur në rrethana specifike, por në mënyrë të qëndrueshme. Nga ky këndvështrim, pavarësisht prej tensioneve momentale të krijuara për motive politike në qarqe greke dhe maqedonase të ditës, marrëveshja do të jetë e qëndrueshme. Ndërkohë për faktorin shqiptar marrëveshja është zgjidhja më e mirë, sepse ajo mënjanon abuzimet etnike me konotacione ekskluzive sllave dhe deformimet lidhur me etnogjenezën e popullsisë maqedonase në atë vend. Shqiptarët ndihen më të relaksuar dhe më të realizuar me emrin e ri.

"Epoka e re": *Këto dy vende nuk janë të vetmet në rajon që kanë probleme mes vete. Nga presioni i BE-së, si duket, çdo vend i Ballkanit Perëndimor është i detyruar ta ndjekë rrugën e Maqedonisë. Si e shihni zgjidhjen e problemeve mes vendeve të rajonit?*

**Bashkurti:** Në kontekstin Ballkanik arritja e kompromisit për emrin, Republikës së Maqedonisë Veriore i hap rajonit rrugë për të hedhur dy hapa të mëdhenj drejt integrimeve euroatlantike: anëtarësimit të plotë në NATO dhe hapjen e negociatave për anëtarësim në BE. Në të dyja këto dimensione të integrimit avancimi i Republikës së Maqedonisë Veriore është me dobi të madhe për vendin dhe për mbarë Ballkanin Perëndimor. Është e vërtetë se BE-ja ka rritur presionin mbi vendet e Ballkanit Perëndimor në tri dimensione: së pari, për t'i zgjidhur problemet bilaterale ndërmjet tyre të bazuara në parimet e fqinjësisë së mirë. Së dyti, për të zhvilluar politika e projekte të përmasave rajonale, që synojnë ta rrisin konektivitetin ndërmjet tyre dhe në tërësi bashkëpunimin rajonal. Së treti, të përpilojnë dhe të zbatojnë një politikë të jashtme dhe diplomaci në linjë me atë të Bashkimit Evropian, për çështjet më madhore ku vendet e BE-së arrijnë një konsensus ndërmjet tyre.

Në të tria këto aspekte shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë sfida për t'u përballur. Në aspektin e parë bilateral, të gjithë kanë probleme bilaterale të një natyre dhe rëndësie të ndryshme. Por, më të mprehtat janë problemet midis Serbisë dhe Kosovës, zgjidhja e të cilave do ta çlironte mbarë Ballkanin Perëndimor nga një nyje bllokuese. Në aspektin e dytë, të konektivitetit dhe kooperimit rajonal, shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë shpalosur vullnet të mirë, por më pak veprime dhe projekte konkrete. Agjendat e ngushta lokale vazhdojnë t'i dominojnë politikat e shteteve individuale, herë për shkak të mungesës së mbështetjes financiare të mjaftueshme nga BE-ja, herë për shkaqe politikisht të motivuara. Në aspektin e tretë, të qasjes së politikës së jashtme dhe diplomacisë së Ballkanit Perëndimor me linjat e dakordësuara të BE-së, sfida themelore ngelet tek Serbia, politika e jashtme dhe diplomacia e së cilës vazhdon të jetë ambige midis BE-së dhe Rusisë. Kjo është dukuri

# rbi do të jetë komplekse



evidente në qasjen e Serbisë ndaj sanksioneve të vendosura nga BE-ja pas krizës së Ukrainës, duket në orientimet strategjike dhe ushtarake serbo-ruse si dhe aspekte të politikës së jashtme të Serbisë ndaj fqinjëve të saj, sidomos ndaj Kosovës, Bosnje-Hercegovinës e Malit të Zi.

**"Epoka e re":** *Në kuadër të arritjeve të marrëveshjeve historike në rajon, me interesim të veçantë pritet ajo në mes të Kosovës dhe Serbisë, e cila do të arrihet në fazën finale të dialogut. Çfarë do të duhej të përmbajë një marrëveshje e tillë dhe sa do të jetë e vështirë arritja e një kompromisi të tillë?*

**Bashkurti:** Do të jetë marrëveshja më e vështirë dhe komplekse në Ballkanin Perëndimor, njëkohësisht marrëveshja përmbyllëse e problematikave më të mprehta të trashëgimisë historiko-politike ballkanike. Marrëveshja do të jetë e vështirë sepse ka të bëjë me një kapërcim epokal të doktrinës së politikës së jashtme të Serbisë lidhur me Kosovën. Kemi parasysh se doktrina tradicionale e politikës së jashtme serbe zë fill nga 'Nacertanie' e Ilia Garashaninit, zhvillohet nga Mbretëria Serbe e vitit 1878, shtrihet më tej nga Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene e vitit 1918, agresivizohet më tej nga platforma 'Përzënia e Shqiptarëve' e Akademisë së Shkencave dhe Arteve në krye me dr. Vasa Çuroliviçin, zhvillohet ende më shumë me Ivo Andriçin, radikalizohet në Jugosllavinë e AVNOJ-it nga Aleksandër Rankoviçi, ripërtërihet nga platforma MANU e Akademisë së Shkencave dhe Arteve në vitet '80 dhe kulmon me aksionin politiko-ushtarak të Milloshevigit në vitet '90.

Kjo platformë kontinuitive serbe nuk është thjesht relike historike, por 'qenie e gjallë' edhe sot e kësaj dite. Është në Kushtetutën e Republikës së Serbisë është në politikën e jashtme, është në aksionin diplomatik, është në doktrinën e Kishës Serbe sikundër në qarqe akademike dhe në shtresa të opinionit publik. Diçka ka lëvizur për të mirë në këtë aspekt. Por, kjo lëvizje është ende larg për ta sjellë ndryshimin cilësor të qasjes së Serbisë ndaj Kosovës.

**"Epoka e re":** *Lidershipi në Kosovë po mundohet ta arrijë një konsensus nacional rreth bisedimeve finale me Serbinë por, si duket, nuk po ia arrin dot. Është i nevojshëm një konsensus i tillë?*

**Bashkurti:** Lidershipi i Kosovës është përballë një sfide të jashtëzakonshme. Marrëveshja do të jetë komplekse sepse do të jetë shumëdimensionale dhe afatgjatë. Për këtë pala e Kosovës lypset të përgatitet shumë mirë. Është e nevojshme që ky proces parapërgatitor të jetë serioz, legjitim, i përgjegjshëm, transparent dhe gjithëpërfshirës. Kërkohet përgatitje institucionale dhe jopersonale, nevojiten përgjegjësi shtetërore dhe jo thjesht protagonizëm individual, transparencë e gjithanshme dhe e përhershme dhe jo informacion i munguar dhe i fragmentuar, lypet gjithëpërfshirje e gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë të mbarë Kosovës dhe jo frymë përjashtimore politikisht e motivuar.

Mendoj se më e shumta e punës përgatitore për këtë marrëveshje përfundimtare është pa u bërë. Më së paku është bërë. Them më së paku se bisedimet Kosovë-Serbi të nisura në pranverë të vitit 2013 kanë ecur ngadalë, me probleme të shumta të lëna pa zgjidhje, pjesa më e madhe të parealizuara në praktikë, një pjesë të kontestuara nga politikat e brendshme dhe opinionet publike të të dy shteteve, sikundër ndërkombëtarisht të pambështetura.

Në tërësi bisedimet Kosovë - Serbi kanë krijuar deri tani më shumë zhgënjime sesa shpresa afrimi, pajtimi dhe bashkëpunimi. Drejtuesit e këtyre bisedimeve të të dy palëve janë treguar përgjithësisht të dobët, pamjaftueshmërisht të aftë dhe u ka munguar guximi prej lidershipi të vërtetë vendimmarrës me vizione historike.

Lidershipet kryesuese të bisedimeve Kosovë - Serbi nuk kanë arritur as të përbashkojnë faktorët politikë të brendshëm dhe as ta sigurojnë mbështetjen ndërkombëtare të mjaftueshme. Procesi i bisedimeve ka ngelur në status quo. Ose, më saktë, ka ngelur në një rreth të mbyllur pa rrugëdalje. Kosova dhe Serbia dhe lideshipet e tyre nuk po kanë energji të mjaftueshme për të dalë vetë nga ky rreth i mbyllur. Kërkohet më tepër energji nxitëse nga BE-ja dhe më shumë mbështetje nga ShBA-ja që situata Kosovë - Serbi të dalë nga gjendja ku ndodhet e ngecur prej kohësh.

**"Epoka e re":** *Nëse kemi një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë, a mund të themi se rajoni i Ballkanit Perëndimor po futet në një fazë të re?*

**Bashkurti:** Pa dyshim definimi i marrëveshjes së përgjithshme Kosovë - Serbi në kuadër të një traktati të plotë miqësie dhe bashkëpunimi midis dy shteteve të pavarura e sovrane, të njohura ndërkombëtarisht dhe anëtare të Kombeve të Bashkuara do të përmbyllte një faqe shekullore problematike midis Serbisë dhe Kosovës, sikundër midis shqiptarëve dhe serbëve përgjithësisht.

Një traktat i tillë Kosovë - Serbi si dhe një frymë e re në marrëdhëniet shqiptaro-serbe do ta hapnin një epokë të re për mbarë Ballkanin Perëndimorë dhe gjithë Kontinentin Evropian. Atë proces paqtimi që Evropa e nisi me projektin Mone në vitet '50 të shekullit të kaluar, Ballkani do ta përmbyllte me marrëveshjen Kosovë-Serbi dhe shqiptaro-serbe në fillimin e mileniumit të ri. Projekti Franko-Gjerman për Evropën dhe projekti Kosovë - Serbi dhe shqiptaro-serb për Ballkanin janë pjesë e një procesi të Evropës në rrugëtimin e saj drejt paqes, demokracisë e prosperitetit.

# Limaj nderohet me mirënjohje nga 'Çamëria'



TIRANË, 19 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, është nderuar të martën me mirënjohje nga Shoqata "Çamëria". Me këtë rast Limaj ka thënë se ndarja e kësaj mirënjohje është nder i madh për të. Ai ka theksuar se është koha që tani në Ballkan të gjitha çështjet e hapura nga e kaluara ta marrin adresimin e merituar siç është edhe çështja e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë në Greqi. "Ishte kënaqësi e jashtëzakonshme që në Tiranë të pranoja mirënjohje nga Shoqata 'Çamëria'. Ky është një nder i madh për mua. Është koha tani që në Ballkan të gjitha çështjet e hapura nga e kaluara ta marrin adresimin e merituar siç është edhe çështja e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë në Greqi. Natyrisht, ne të gjithë presim që gjatë bisedimeve, Shqipëria dhe Greqia ta përmbyllin edhe këtë çështje duke i respektuar të drejtat e njeriut", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

# Bytyqi: Angazhimi i përbashkët krijon mundësi për arsim cilësor

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, gjatë tryezës me temën "Prioritetet në fushën e arsimit parauniversitar", ka theksuar se vetëm angazhimi i përbashkët krijon mundësi për arsim cilësor në Kosovë



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të martën në tryezën me temën "Prioritetet në fushën e arsimit parauniversitar", të iniciuar nga MAShT-i dhe GIZ-i, si lider i fushatës "Për një arsim më të mirë në Kosovë" dhe të organizuar nga Komisioni Parlamentar për Arsim. Kjo tryezë kishte për qëllim të sigurojë hapësirë për MAShT-in dhe partnerët mbështetës të fushatës që t'i shprehin shqetësimet dhe sugjerimet e duhura se si mund të përmirësohet gjendja në arsim. Po ashtu, kjo tryezë kishte për synim avokimin e fuqishëm në Kuvend dhe Qeverinë e Kosovës, që arsimi të bëhet prioriteti i parë në nivel vendi.

Ministri Bytyqi me këtë rast ka theksuar se vetëm angazhimi i përbashkët i të gjitha strukturave dhe i të gjithë aktorëve që kanë ndikim në arsim mund të krijojë kushte për një arsim cilësor dhe edukim të mirëfilltë për të cilin ka nevojë vendi ynë. Bytyqi ka thënë se Ministria e Arsimit së bashku me partnerët zhvillimorë është duke u angazhuar maksimalisht që të realizohet PSAK 2017/2021, ku në kuadër të kësaj strategjie janë të parapara ndryshimet që çojnë në atë për të cilën ka nevojë sistemi i arsimit në Kosovë. "Në diskutimet e MAShT-it me GIZ-in janë identifikuar prioritetet kryesore afatshkurtra të cilat mund të ndërmerren, në mënyrë që të fillojnë ndryshimet në sistemin arsimor. Janë identifikuar pesë prioritete kyçe, pavarësisht që PSAK 2017/2021 parasheh shtatë fusha kyçe. Por, për shkak të pamundësisë buxhetore duhet të fokusohemi në prioritetet kryesore të cilat do të ndikonin në ndryshimin e cilësisë brenda sistemit arsimor në Kosovë", është shprehur ministri Bytyqi.

Si prioritet të parë, i cili parashihet edhe në kuadër të PSAK-ut, ministri Bytyqi ka thënë se është licencimi i bazuar në performancë, ku në kuadër të kësaj fushe nga shtatori i këtij viti do të fillojë matja e performancës së mësimdhënësve. Pjesë e prioritetit të parë është edhe trajnimi i mësimdhënësve, praktika njëvjeçare para se të nënshkruhet kontrata e përhershme e punës dhe ngritja në karrierë.

Prioriteti i dytë, i cili është nxjerrë nga PSAK-u, është hartimi i teksteve të reja sipas standardeve ndërkombëtare. Në këtë drejtim ministri Bytyqi ka thënë se është bërë një hap pozitiv duke shpallur thirrje publike për hartuesit e teksteve shkollore për pjesën e parë, ndërsa pjesa e dytë do të shpallet në fund të korrikut, në mënyrë që deri në vitin shkollor 2019/2020 tekstet e reja shkollore për të gjitha nivelet të jenë të gatshme për përdorim. Ministri Bytyqi ka theksuar nevojën për buxhet shtesë sa i përket pagesës së recensentëve dhe ekspertëve deri në finalizimin e teksteve të reja.

Prioritet i tretë konsiderohet çështja e gjithëpërfshirjes në edukimin parashkollor, përkatësisht rritjen e shkallës së përfshirjes në nivelin 0-5, si dhe vetëdijesimin e prindërve për rëndësinë e edukimit 0-2 vjeç.

Prioriteti i katërt u theksua sistemi i menaxhimit të shkollave, ku u pa i nevojshëm të fuqizohet roli i prindërve. "Prioriteti i pestë është planifikimi i integruar i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017/2021", ka thënë Bytyqi, për të cilin prioritet ka thënë se nuk ka mjete të mjaftueshme për realizim të plotë.

# Ministri Berisha falënderon Suedinë për mbështetjen që po i jep FSK-së



PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrustem Berisha, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Mbretërisë së Suedisë, Henrik Nilsson. Në takimin e tyre të parë, ministri Berisha dhe ambasadori Nilsson biseduan për marrëdhëniet e mira shtetërore ndërmjet dy vendeve, sidomos për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e mirë në fushën e sigurisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Suedisë.

Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, e ka falënderuar ambasadorin Nilsson për kontributin që ka dhënë Suedia për Kosovën dhe popullin e saj, sidomos për mbështetjen që i ka dhënë FSK-së për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të kërkim-shpëtimit të FSK-së dhe Qendrës së Trajnimit për Kërkim - Shpëtim dhe në fusha të tjera, përmes oficerëve të Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s për MFSK/FSK-në si dhe për kontributin e kontingjenteve ushtarake suedeze në kuadër të KFOR-it për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend.

Ndërsa ambasadori suedez Henrik Nilsson në fillim i ka dorëzuar ministrit Berisha një letër të adresuar për të nga ministri i Mbrojtjes së Mbretërisë së Suedisë, në të cilën shprehte falënderimin për ngritjen e monumentit në Prishtinë për ushtarët e NATO-s dhe të KFOR-it si mirënjohje dhe nderim për kontributin e tyre për lirinë e vendit dhe ruajtjen e paqes në Kosovë nga viti 1999 e deri më 2018.

Ministri Berisha dhe ambasadori Nilsson gjatë këtij takimi shprehën gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe shtimin e tij dhe të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, dy ministrive dhe të dy forcave edhe në të ardhmen.

## SBAShK-u edhe këtë vit dërgon në pushime 425 punëtorë të arsimit

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBAShK) edhe këtë vit do të dërgojë në pushime një numër të konsideruar të anëtarëve të vet. "Bazuar në mjetet e akumuluara në fondin për pushim e rekreacion, këtë vit u bë e mundur që në bregdetin shqiptar të dërgohen për pushime 425 punëtorë të arsimit nga e tërë Kosova", është bërë me dije në njoftimin e SBAShK-ut.

Grupi i parë prej 110 pushuesve tanimë është në pushim në Durrës. "Përshtypjet e tyre janë të shkëlqyera. Ata të mbështetur nga Komisioni mbikëqyrës i SBAShK-ut, krahas pushimit, po zhvillojnë edhe takime në të cilat flasin për angazhimet sindikale dhe për mobilizimin e shtuar që duhet bërë në përpjekje për arsim edhe më të mirë në Kosovë", është thënë në njoftimin e SBAShK-ut.

Pasi t'i përfundojë pushimet grupi i parë, do të dërgohen për pushime edhe 315 anëtarë të SBAShK-ut nga e gjithë Kosova.



Lansohet kampanja "Bëhu zëri im" në përkrahje të të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë

# Viktimat e dhunës seksuale kanë nevojë për përkrahjen e shoqërisë

**Të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë më shumë se kurrë kanë nevojë për përkrahjen e shoqërisë sonë. Kështu është thënë të martën në lansimin e kampanjës "Bëhu zëri im" në përkrahje të viktimave të dhunës seksuale. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se nderi dhe dinjiteti i këtyre viktimave duhet rikthyer përmes mirëkuptimit në forcë dhe besim. Ai ka theksuar se ato dhe ata duhet të kenë ardhmëri dhe, sipas Thaçit, kjo mund të arrihet vetëm duke u bërë zëri i tyre**



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), në bashkëpunim me Medica Gjakova (MGj), të martën kanë lansuar kampanjën "Bëhu zëri im" në përkrahje të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Pjesë e marshit të mbajtur nga Sheshi "Skënderbeu" deri te Sheshi "Zahir Pajaziti" kanë qenë presidenti Hashim Thaçi, ambasadori amerikan Greg Delawive, ambasadori britanik Ruari O'Connell, shefja e Zyrës së BE-së, Natalya Apostolova, ish-presidentja Atifete Jahjaga si dhe zyrtarë të tjerë vendorë e ndërkombëtarë. Me këtë rast presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se të mbijetuarat e dhunës seksuale kanë nevojë për përkrahjen e shoqërisë sonë. Ai ka theksuar se lansimi i kampanjës "Bëhu zëri im" është bërë pikërisht në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikte, e cila synon ta tërheqë vëmendjen e shoqërive dhe të shteteve demokratike për këtë dukuri që e pengon ndërtimin e paqes. "I dimë të gjithë krimet që Serbia i ka bërë në Kosovë. Kurdoherë do të japë përgjegjësi për to. U mundua me çdo kusht të na zhveshë prej çfarëdo vlere njerëzore, duke përdorur edhe dhunën seksuale si taktikë çnjerëzore të luftës. U mundua të na nëpërkëmbë. Madje, edhe të na turpërojë deri te përjashtimi dhe vetë izolimi i njëri-tjetrit. Por, të jemi deri në fund të qartë: të mbijetuarat e dhunës seksuale nuk janë fajtore për atë që u ndodhi. Ato janë viktima. Janë të mbijetuara që më shumë se të gjithë, kanë nevojë për përkrahjen e shoqërisë sonë", është shprehur Thaçi.

Edhe pse Kosova njihet për aktivitete që kanë rritur ndërgjegjësimin publik, sipas tij, duhet të bëhet më shumë për t'i dhënë fund dhunës seksuale në konflikte. "Duhet të bëjmë më shumë për t'i përkrahur të mbijetuarat apo mbijetuarit, duke ua kthyer besimin në vetvete. Lëndimin e tyre duhet ta shërojmë së bashku. Nderi dhe dinjiteti i tyre duhet rikthyer përmes mirëkuptimit në forcë dhe besim. Ato dhe ata duhet të kenë ardhmëri", ka thënë Thaçi.

Presidenti është shprehur mirënjohës edhe ndaj Qendrës për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës në Kosovë për angazhimin e tyre, por edhe ndaj organizatave të tjera që më punë të pandalshme i kanë luftuar të gjitha paragjykimet që mbizotërojnë në shoqërinë tonë në raport me këtë grup të ndjeshëm shoqëror. "Këtë mund ta arrijmë vetëm duke u bërë zë i tyre", ka thënë Thaçi.

Ndërsa ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ka thënë se të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës ende përballen me stigmatizim nga shoqëria. Sipas saj, mungesa e drejtësisë ka shndërruar jetën e tyre në një makth. "Kjo dhunë edhe dy dekada pas përfundimit të luftës vazhdon të jetë e gjallë për çdo viktimë. Mungesa e drejtësisë ka shndërruar jetën e tyre në një makth. Të mbijetuarit e dhunës seksuale ende përballen me stigmatizim", është shprehur Jahjaga. Ajo ka thënë se duhet të kërkohet llogari nga Serbia për krimet që ka shkaktuar ndaj këtyre njerëzve që trupin e tyre e shndërruan në fushëbetejë. "Të mbijetuarit e luftës i kemi diskriminuar edhe me narracionin që kemi krijuar. Të mbijetuarve të dhunës seksuale nuk u njihet sakrifica. Ne kemi lëvizur shumë gjëra në drejtimin e duhur, por duhet të bëjmë ende më shumë. Përgjatë viteve kemi arritur përparime të dukshme. Arritëm ta ndryshojmë legjislacionin për të mbijetuarit e luftës. Ne treguam se dhunimi seksual ka ndodhur në shkallë të madhe në vendin tonë dhe treguam se bota nuk duhet t'i mbyllë sytë. Ne duhet të kërkojmë llogari nga Serbia për krimet që ka shkaktuar ndaj këtyre njerëzve që trupin e tyre e shndërruan në fushëbetejë", ka deklaruar Jahjaga.

Kampanja "Bëhu zëri im", në përkrahje të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, është lansuar në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikte në përkrahje për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.



# Thaçi takon ambasadorët e Quintit, koordinohet për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të martën në takim ambasadorët e vendeve të Quintit, ambasadorin e ShBA-së Greg Delawie, ambasadorin britanik Ruairi O'Connell, ambasadorin e Francës Dider Chabert, ambasadorin e Italisë Piero Cristoforo Sardi, zëvendësambasadorin e Gjermanisë Jan-Axel Voss, dhe shefen e Zyrës së BE-së, Natalyia Apostolova.

Presidenti Thaçi i ka njoftuar ambasadorët se e ka pranuar ftesën e përfaqësueses së lartë të BE-së, Federica Mogherini, për takimin e ri në Bruksel, të dielën më 24 qershor. Sipas njoftimit të Presidencës, përfaqësuesit e shteteve të Quintit kanë rikonfirmuar përkrahjen e tyre për fillimin e fazës përfundimtare të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve në mes dy shteteve. "Kosova është e gatshme për dialog dhe për normalizim të marrëdhënieve", është shprehur presidenti Thaçi, duke theksuar nevojën e një përfshirjeje sa më të gjerë të partive politike, shoqërisë civile dhe medieve.



# Hamza e O'Connelli diskutojnë për bashkëpunimin ekonomik

Prishtinë, 19 qershor (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, me të cilin ka diskutuar për të arriturat gjatë këtij gjashtëmujori të parë në fushën e financave publike. Me këtë rast ministri Hamza ka falënderuar ambasadorin O'Connell dhe shtetin britanik, si partner strategjik i Kosovës, për ndihmën që vazhdon të japë për Kosovën. Më tutje, ai e ka njoftuar ambasadorin britanik për progresin dhe të arriturat në Ministrinë e Financave, për trendin pozitiv të të hyrave dhe nivelin e shpenzimeve buxhetore, buxhetin e shtetit gjatë këtij gjashtëmujori, si dhe për stabilitetin makro-fiskal në përgjithësi. Ndërsa ambasadori i Britanisë së Madhe, Ruairi O'Connell, ka shprehur gatishmërinë e shtetit britanik për vazhdimin e mbështetjes dhe bashkëpunimin me Kosovën për realizimin e planeve strategjike në fushën e financave.



# Në Gjakovë vihet gurthemeli i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura



Gjakovë, 19 qershor (ER) - "Gurthemeli i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Gjakovë është një proces i angazhimit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, donatorëve dhe ujësjellësve për të ta kompletuar gjithë sistemin nga prodhimi i ujit deri te trajtimi i ujërave të zeza në vend", ka thënë ministri i MZhE-së, Valdrin Lluka. Këto komente kreu i MZhE-së i bëri gjatë ceremonisë së vënies së gurthemelit të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në vlerë prej 17 milionë eurosh, ku morën pjesë drejtues të institucioneve, ambasadorë të vendeve donatore dhe aktorë të sektorit të ujërave.
Ministri Lluka ka theksuar se ky sukses nuk do të ishte i arritshëm pa ndihmën e donatorëve, Qeverisë së Gjermanisë dhe asaj zvicerane. "Sot në Kosovë trajtojmë vetëm 2 % të ujërave të zeza, kurse në vendet e zhvilluara është e kundërta. Por ne do ta ndërrojmë këtë kahun. Impianti për trajtimin e ujërave të zeza ka filluar në Prizren, tash po fillon në Gjakovë, shumë shpejt do të fillojë në Pejë. Këto tri impiante dhe me impiantin që është në proces e sipër në Prishtinë, do t'i trajtojmë rreth 60 % të ujërave të zeza në Kosovë", ka thënë Lluka.

# Bujqit e Gadimes i gëzohen investimit të KEDS-it

Lipjan, 19 qershor (ER) - Një projekt shumë të rëndësishëm investiv sapo ka përfunduar KEDS-i në fshatin Gadime e Epërme të Lipjanit. Fjala është për projektin e quajtur TS Shkolla Gadime, projekt ky që do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë të furnizimit dhe rënien e humbjeve.
Projekti është pritur tepër mirë nga banorët e kësaj ane, të cilët kryesisht merren me bujqësi.
Gjatë implementimit të projektit KEDS janë vendosur tri trafostacione, dy me fuqi prej 160 kV, një me fuqi prej 250 kVA. Gjithashtu, janë vendosur 99 shtylla betoni për tensionin e ulët dhe 66 shtylla për tensionin e mesëm. Janë shtrirë edhe 6 km kabllo ajrore për tensionin e ulët dhe 2 km rrjet të tensionit të mesëm. Janë 130 familje që përfitojnë nga ky investim.
Gjendja energjetike në këtë fshat ka qenë tepër e rëndë, mbingarkesat shpesh sillnin ndërprerje të energjisë elektrike dhe banorët thonë se kanë pasur problem për t'i përdorur edhe pajisjet më të thjeshta shtëpiake.



# Gërxhaliu: Kosova urgjentisht duhet të aplikojë për anëtarësim në OBT

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë se institucionet e vendit duhet ta kthejnë vëmendjen drejt ekonomisë. Ai ka thënë se Kosova urgjentisht duhet të aplikojë për anëtarësim në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Kurse Sytrime Dervisholli nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) nuk ka dhënë ndonjë datë se kur Kosova do të aplikojë për anëtarësim në OBT, por ka theksuar se për këtë duhet koordinim mes institucioneve përgjegjëse




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, në një konferencë për medie mbajtur të martën ka apeluar tek institucionet e vendit që ta kthejnë vëmendjen drejt ekonomisë. Ai ka thënë se agjenda ekonomike duhet të jetë prioritet i institucioneve vendore në mënyrë që të zihet hapi i agjendave evropiane. "Në një vend ku agjenda politike është e stërngarkuar, mbetet për t'u dëshiruar sa i përket ekonomisë. Por, anëtarësimi i Kosovës në OBT është i rëndësisë së pakontestueshme. Është koha kur duhet të jemi më pragmatikë, prandaj duhet të bëhet hapi i parë: aplikimi për anëtarësim në OBT", ka thënë Grëxhaliu, duke shtuar se Kosova fillimisht do të jetë vetëm në rolin e vëzhgueses në OBT. "Kosova është i vetmi vend i rajonit që ende nuk ka bërë kërkesë zyrtare për anëtarësim në OBT. Kosova fillimisht duhet të jetë vëzhguese në këtë organizatë. Anëtarësimi në OBT fillimisht do të jetë më shumë i dimensionit politik sesa ekonomik. OBT-ja me seli në Gjenevë të Zvicrës ka nën petkun e vet 164 shtete dhe kjo do t'i përforconte edhe raportet politike me këto shtete", ka thënë ai.

Gërxhaliu ka bërë me dije se nga anëtarësimi në këtë organizatë fillimisht efektet nuk mund të jenë pozitive për shkak të aftësisë sonë jokonkurruese me vendet anëtare. "Në periudhën afatshkurtër nuk pritet të kemi rezultate pozitive për shkak të aftësisë sonë të dobët konkurruese, por në periudhën afatgjatë efektet do të jenë pozitive, duke filluar nga balanca tregtar, tërheqja e investimeve të huaja, përmirësimi i imazhit dhe ulja e shkallës së papunësisë", është shprehur Gërxhaliu.

Ai ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në OBT është edhe kërkesë e Odës Ekonomike të Bashkimit Evropian, ku është anëtare edhe OEK-u.

Kurse Sytrime Dervisholli nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka bërë një rezyme rreth historikut të Kosovës në drejtim të OBT-së. Ajo ka thënë se që dy vjet e gjysmë kanë filluar hapat në këtë drejtim sa iu përket dokumentacioneve.

Dervisholli ka thënë se MTI-ja nuk ka qëndruar duarkryq në këtë proces. Sipas saj, MTI-ja ka zhvilluar vizita në Gjenevë nga ku dolën rekomandimet që Kosova të aplikojë në rolin e vëzhguesit në OBT.

Në pyetjen se kur pritet që Kosova të aplikojë për anëtarësim në OBT, Dervisholli nuk ka thënë ndonjë datë konkrete, por ka theksuar se për këtë çështje duhet të ketë koordinim mes institucioneve përgjegjëse. "Jemi në biseda me zyrën e kryeministrit. Po ashtu, është duke u bërë punë edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme. Pra, kemi një trekëndësh koordinimi në këtë proces", ka deklaruar Dervisholli.

Kurse njohësi i çështjeve ekonomike, Naim Huruglica, ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në OBT është i një rëndësie të veçantë. "Që nga çlirimi i vendit është bërë shumë sa i përket legjislacionit, por nuk janë parë rezultate në shifra, marrë parasysh disbalancin e lartë tregtare. Problemi nuk është aspekti legjislativ, por dora e padukshme e shtetit dhe e grupeve të interesit. Andaj më lehtë është të eksportosh në vendet e BE-së sesa në Shqipëri", ka thënë ai.

Edhe Berat Rukiqi nga OEK-u ka folur për rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në OBT. "Të qenit anëtar në një organizatë me 164 shtete anëtare, pos dimensionit tregtar, do të ketë edhe avancim të raporteve politike. Nga praktika e vendeve të tjera, procesi i anëtarësimit në OBT i ka ndihmuar edhe përshpejtimit të marrëveshjeve të stabilizimit. Në këtë organizatë është shumë me rëndësi mbrojtja e pronësisë intelektuale. Pra, do t'u garantonte siguri investitorëve të huaj në Kosovë, po ashtu këtu mund të rrisim dhe eksportin e shërbimeve", ka thënë Rukiqi.

# IPKO-ja mbyll kodin e telefonisë fikse +381

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Kompania IPKO ka njoftuar klientët se kodi ekzistues i telefonisë fikse +381 nuk do të ekzistojë më. "Prej datës 20 qershor 2018 të gjitha thirrjet ndërkombëtare që realizohen drejt telefonisë fikse, do të realizohen vetëm përmes kodit të ri shtetëror +383", është bërë me dije në njoftimin e IPKO-s.

IPKO-ja ka njoftuar se teknikisht është e gatshme të migrojë tërësisht në kodin e ri shtetëror dhe në telefoninë mobile. "Hapi kryesor i migrimit të tërësishëm tashmë veç është zbatuar më 17 prill të këtij viti. Ky hap ka mundësuar që të gjithë përdoruesit e telefonisë fikse dhe mobile të identifikohen me +383, njëkohësisht të gjithë përdoruesit e IPKO-s kanë pranuar dhe realizuar thirrje përmes kodit të ri shtetëror", thuhet në njoftim, duke shtuar se kjo kompani me sukses i ka përfunduar të gjithë hapat teknikë dhe operativë për kalimin nga kodi +386 në +383 dhe momentalisht është në pritje të disa operatorëve të ndryshëm nga bota që ta hapin rangun drejt kodit të ri shtetëror, në mënyrë që t'u mundësohet përdoruesve të këtyre operatorëve të realizojnë thirrje drejt +383. "IPKO dëshiron të sigurojë të gjithë përdoruesit e telefonisë së saj, që të jenë tërësisht të qasshëm nga e gjithë bota. IPKO do të informojë me kohë, lidhur me mbylljen edhe të kodit të telefonisë mobile +386 dhe, në të njëjtën kohë, i falënderon të gjithë përdoruesit e saj për mirëkuptimin dhe durimin gjatë këtij procesi të rëndësishëm, thuhet në njoftimin për media nga IPKO", është theksuar në njoftimin e IPKO-s.



## Në Komunën e Rahovecit fillon regjistrimi i nxënësve në klasat e dhjeta



RAHOVEC, 19 QERSHOR (ER) - Ka filluar regjistrimi i nxënësve në klasat e dhjeta në shkollat e mesme të larta dhe në Shkollën Profesionale në Komunën e Rahovecit. Regjistrimi do të bëhet duke u bazuar në konkursin publik i cili është përgatitur nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe që është në uebaqen zyrtare të komunës.

Drejtori i Drejtorisë Komunale të Rahovecit, Avni Morina, ka thënë se nga sot ka filluar regjistrimi i nxënësve në klasa të dhjeta për vitin shkollor 2018/2019. Ai ka bërë me dije se në koordinim me drejtorët e shkollave është i përgatitur për këtë proces të regjistrimit, gjithashtu thotë se janë bërë të gjitha përgatitjet për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018. Regjistrimi do të zgjasë deri më 21 qershor.

# Drejt hapjes së muzeut me veprat e artistit Ibrahim Kodra

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka nënshkruar memorandum të mirëkuptimit me Fondacionin "Ibrahim Kodra", me qëllim të themelimit, zhvillimit dhe promovimit të muzeut të artistit Ibrahim Kodra.

Komuna do të angazhohet për ta kthyer objektin e ish-bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në hapësirë kulturore për shfrytëzim si ekspozitë afatgjatë e koleksionit të artistit në fjalë. Po ashtu, do të bëhet projektimi dhe do të kryhen punimet e nevojshme ashtu që objekti të jetë i përshtatshëm për nevoja të muzeut.

Gjithashtu, komuna do ta caktojë kryesuesin e bordit nismëtar për themelimin e muzeut (bord që do të ketë edhe nga dy anëtarë nga të dyja palët), si dhe do ta ndihmojë organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike.

Fondacioni "Ibrahim Kodra" do t'i ofrojë për shfrytëzim pikturat origjinale të autorit për 30 vjet, me mundësi vazhdimi, si dhe do të krijojë program edukativ për artin figurativ për fëmijët dhe të rinjtë të cilin do ta ketë në dispozicion muzeu.

Palët në këtë memorandum janë pajtuar që Muzeu "Ibrahim Kodra" të menaxhohet nga Muzeu i Prishtinës.



# Në Prizren lansohet programi i skriningut të kancerit të qafës së mitrës

PRIZREN, 19 QERSHOR (ER) - Të martën është lansuar programi i skriningut të kancerit të qafës së mitrës në Komunën e Prizrenit, program ky që po bëhet i mundur si rrjedhojë e suksesit të programit në Prishtinë. Ky program do ta mundësojë ofrimin e paptestit për rreth 400 gra nga Komuna e Prizrenit, gjatë fazës së parë të implementimit, gjegjësisht në vitin 2018. Po ashtu, do të ndërtohen kapacitetet për skrining brenda Kujdesit Parësor Shëndetësor




(KPSh) në Prizren si dhe do të ndërtohet algoritmi procedural që rregullon sistemin e bashkëpunimit në mes të KPSh dhe Kujdesit Dytësor Shëndetësor - Laboratorit të Patologjisë.

Përpos ofrimit të këtij shërbimi të ri në kuadër të kujdesit parësor, palët synojnë të iniciojnë diskutime në mes të institucioneve dhe grupeve të interesit me qëllim të hartimit dhe implementimit të politikave shëndetësore që ndërtojnë një sistem cilësor të skriningut të kancerit të qafës së mitrës si e drejtë shëndetësore, e paraparë me Ligjin për Shëndet Riprodhues, si dhe e planifikuar në Programin Nacional për Kontrollin e Kancerit.

Ky program, përmes paptesteve për gratë dhe vajzat nga Komuna e Prizrenit, do ta mundësojë zbulimin e hershëm të qelizave jonormale të qafës së mitrës dhe trajtimin e tyre me sukses për ta parandaluar kancerin e qafës së mitrës.

# Inspektori i ndërtimit dënohet me dy vjet burgim për ryshfet



GJILAN, 19 QERSHOR (ER) - Gjykata Themelore në Gjilan ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit B. A. I akuzuari shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, dyshohet se gjatë muajit nëntor 2015, në cilësinë e personit zyrtar, inspektor i ndërtimit, fillimisht ka kërkuar ryshfet në shumën prej 5 000 eurosh nga i dëmtuari A. I, që të mos rrënojë një pjesë të objektit i cili ishte mbindërtim, ndonëse ishte në kundërshtim me leje ndërtimore në objektin banesor, duke e ftuar në celular disa herë për t'u takuar dhe më pas ka marrë shumën e të hollave prej 3 000 eurosh nga i dëmtuari. "Me këto veprime i akuzuari B. A. ka kryer veprën penale marrje e ryshfetit nga neni 428, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)", është thënë në njoftimin e Gjykatës Themelore të Gjilanit.

## Fillon faza e dytë e dezinsektimit hapësinor në kryeqytet

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Sot (e mërkurë) fillon faza e dytë e dezinsektimit hapësinor në Komunën e Prishtinës. Komuna e Prishtinës ka njoftuar se kjo ditë është zgjedhur pas të gjitha përgatitjeve teknike dhe operative nga ana e komunës dhe kompanisë pasi që parashikimet klimatike sigurojnë një javë me mot stabil dhe pa reshje, për arsye se reshjet gjatë procesit të dezinsektimit e bëjnë të paefektshëm aksionin. "Duke u bazuar në këto të dhëna, sivjet do të dezinsektohet një sipërfaqe e përgjithshme mbi 6 000 hektarë, duke përfshirë edhe zona rurale ku ka potencial të lartë të zhvillimit të këtyre insekteve. Edhe këtë vit do të përdoren preparatet e sigurta të regjistruara për përdorim në vendet e Bashkimit Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Dezinsektimi do të bëhet çdo ditë duke filluar nga ora 19:30 deri në orën 23:30 (24:00)", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



# HASHIMI, JUL CEZARI I KOSOVËS; BEKIMI, KUASIMODO I HASHIMIT!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

**Qe sa kohë nuk u përqafuam, shpirti po më digjet:** Shqiptarët e lashtë janë deklaruar si hamshorë. Thashë janë deklaruar, pa u vërtetuar hamshorizmi i tyre, kurse kosovarët e rinj, e që janë hirra e shqiptarëve të dikurshëm, sipas shokut Tito, kriminelit të tërbuar antishqiptar, përjashtuar disa shqipfolësve që në kohën e tiranisë së tij kanë jetuar pak më keq se që jetojnë sot, sipas mësimeve: "sa reçi ne della", nga fjalët në vepra janë shndërruar në dashnorë që aventurat e tyre i shpërfaqin në fejsbuk, krevat ku mund të rreni sa të doni dhe kur të doni dhe, nëse keni ndjekës, disa të besojnë apo disa kanë hamendësime për sasinë e testosteronit me të cilën mburreni. Faturë për këtë është edhe zbulimi i një shqiptari të lashtë me produktin Viagra dosh Santos, duket si të jetë ndonjë lojtar i Benfikas së Portugalisë. Madje, në një takim me një delegacion të lartë të një vendi mik, një deputet jashtëzakonisht i kthjellët kosovar, nuk ka deputetë jo të kthjellët (harrojeni këtë), ua ka përkujtuar se pikërisht Ferid Murati, me zbulimin e tij po i gëzon gratë e miqve tanë pas së cilës mori përkrahje 100 % për liberalizimin e vizave dhe proceset e integrimit në BE, NATO dhe korporatën Koza Nostra në Itali, prandaj nuk e kuptoj pse Kadriu, me ekipin jashtëzakonisht profesional për lobim, po humbet kohë duke shëtitur, nga shteti në shtet. Duket se po zbatohet taktika që përdoret gjatë zgjedhjeve, nga dera në derë në kërkim (të blerjes) së votës. Sa iu përket përqafimeve, Hashimi është Zhigolo nr. 1 në Kosovë. Do të bëhen pjesë e antologjisë dhe enciklopedisë botërore të erotikës politike përqafimet pasionante midis baroneshës Ashton dhe Hashimit dikur dhe tash midis Frederika Mogerinit dhe presidentit tonë legjendar. Skena të parë më herët vetëm të "Doktor Zhivago", "Lufta dhe paqja" dhe në "Kasablanka". Ma çfarë Omar Sharifi apo Lorenci i Arabisë, krahasuar me Hashimin tonë të dashur, të votuar dhe shumë të respektuar?! Hashimi edhe më tutje vazhdon përqafimet me Frederika Mogerinin, por hetohet të këtë rënie pasioni, ose në mungesë të testosteronit, stresit për fatin e Kosovës dhe qytetarëve të saj që me aq dinjitet i përfaqëson në këto bisedime apo ndonjë arsye tjetër për të cilën nuk kam informacione të mjaftueshme dhe të besueshme. Kosova ka një perspektivë të qartë evropiane, prandaj i ka pranuar disa vlera të shtuara evropiane siç janë të drejtat e mohuara të komunitetit LGBT. Në këtë kontekst rol të jashtëzakonshëm për afirmimin e këtyre vlerave si dhe përligjen e tyre ka ish-kryetari i Kuvendit, miku im, Jakup Krasniqi, që e futi në Kushtetutë të drejtën e martesave, kush të dojë, me kënd të dojë! Sikur që e kanë bërë të gjitha shtetet më demokratike në botë. Madje, edhe Papa Françesku, në pyetjen e një gazetari nëse i dënon martesat midis një gjinie, dha një përgjigje epike: "Kush jam unë që t'i gjykoj martesat e tilla ...". Realisht Jakupi ishte më largpamës se Papa, në këtë drejtim, duhet ta pranojmë. Dhe krenohemi për këtë! Lëre ti kancelaren Merkel, me botëkuptime arkaike që nuk e votoi ligjin për këso martesash në Bundestagun e Gjermanisë. Hashimi bëri hap revolucionar dhe shumë të guximshëm kur në Paradën e Krenarisë, krenar dhe ballëlartë doli në krye të kësaj parade. Udhëheqësi i vërtetë merr përgjegjësi konkrete në raste me shumë rëndësi për shtetin dhe kombin! Hashimi i vazhdoi përqafimet dhe po i vazhdon me një pasion ballkanik tash, me partnerë të rinj, Ivica Daçiq dhe Aleksandar Vuçiq. Moti e njoh Hashimin, në momente të caktuara e kam përkrahur, mirëpo kurrë nuk ka ndodhur të më përqafojë sikur Daçiqin apo Vulinin. Nuk është se jam ndonjë bukurosh dhe sigurisht se nuk jam më i bukur se Aleksandar Vuçiqi por, për Ivica Daçiqin jam Monika Belluçi. Mos të flasë për Aleksandar Vulinin i cili, edhe me sjellje, sidomos me pamje, është i pakonkurrencë për ta luajtur rolin e Kontit Drakula. Në këtë pikë shfaqet xhelozia ime ndaj Hashimit, besoj me plot arsye. Dhe e kërkoj përkrahjen tuaj për këtë, lexues të nderuar. Sa iu përket përqafimeve, Zezdita Tahiri është shumë më konservatore dhe më tradicionale se Hashimi, e ka vetëm një partner, Kuperin me kravata lara-lara, me motive të faraonit Tutankamon dhe Remzes së 69. Besnike është Zezdita. Ky pisi, Slloba i vogël, nuk po ia lëshon sytë Zezditës, po dëshiron ta ngulë dhëmbin te Vlora sikur Hashimi te përkthyesja e Sllobës. Që të dyve ka me iu dalë dhëmbi sikur i qenit dhe do t'u bjerë pa e ngulur askund, edhe në rastin se do t'ua mprehë Dr. Meti!!!

**Zbehje për shkak të pagjakësisë apo mungesës së dashurisë:** Hashimi kohët e fundit e ka një rënie të shkëlqimit, tenin e ka disi të zbehtë, të hijezuar. Pse, dhe si t'i kthehet shkëlqimi i mëparshëm?! E pati një përmirësim të çastit kur e takoi baroneshën Ashton gjatë promovimit të librit të tij të parë. Jam i sigurt se është vetëm fillimi i veprave të zgjedhura, që nuk dihet se ku dhe kur do të përfundojnë. Po gjatë kësaj periudhe iu kthye ereksioni politik kur i mori ngrykë gjeneralët e pensionuar, politikanët me afat të skaduar, miqtë dhe përkrahësit e tjerë që luajnë rol vendimtar në zhvillimet botërore. Një kohë të gjatë nuk po funksionon takimi midis Hashimit dhe Vuçiqit, Bekimit dhe Daçiqit. Nuk ka më skena të zjarrta të erotizmit politik, përqafime dhe puthje pasionante sikur që kishte dikur. Kultura jonë nuk na lejon të puthemi në vende publike, në korridore apo shkallë ku, kohët e fundit, janë takuar Hashimi dhe Vuçiqi. Hashimi dhe Vuçiqi nuk luajnë lojë lepujsh, por atë të luanëve. As në planin sentimental e lëre më në atë politiko-mental. Zezdita me Kuperin më nuk janë as pjesë e kujtesës romantike prandaj, me metoda alkimike, atë që e ka bërë m..t më parë, po përpiqet ta flakërojë me ari, kurse për zëvendësin e Zezditës, Avniun, është herët të flitet nëse ka apo nuk ka mungesë pasioni. Mendoj se vetë Avniu, me disa që i ka me vete, po të të përqafojnë e lëre po të të puthin, do ta keni të garantuar impotencën, madje edhe për disa muaj. Më në fund po vijnë kohë të mira për Hashimin, e sidomos për Kosovën dhe dy milionë qytetarë të saj, besnikë të Hashimit. Sipas medieve të shtetit që sot u bë kryelajm botëror duke ia ndaluar hyrjen Shkëlzenit (vakti e ha kashtën) në Serbi, të dielën do ta kemi takimin dhe përqafimin e radhës midis Hashimit dhe Vuçiqit. Avniu ishte dje në Bruksel ku askush nuk e përqafoi dhe askënd nuk e përqafoi e puthjet eventuale do të ishin bonus. Nuk ka dilemë se, në ndërkohë, seksi politik midis Hashimit dhe Vuçiqit ka vazhduar në hot-line, por kjo është vetëm paralojë, në mungesë të kontaktit fizik, me orgazëm të papërfunduar. Me durim të tensionuar po e presim ditën e diel dhe ta shohim se kush kujt do t'ia ngulë. Unë nuk kam dilemë për këtë, prandaj duhet të bëhemi gati të jemi në shërbim të Hashimit, atë që nuk mund t'i bëjë Vuçiqit, na e bënë neve. Kjo është sakrificë krejtësisht normale në rrugën e shtetndërtimit dhe forcimit të rolit të Kosovës në skenën ndërkombëtare. Me të madhe po e kundërshtojnë Hashimin, si kryenegociator, pa e marrë bekimin e Kuvendit i cili, që nga koha e Ali Bungut, edhe me deputetët e partive që po e kundërshtojnë sot fuqishëm, ia ka dhënë Hashimit të drejtën e kryenegociatorit derisa të marrë frymë. Tash po e kundërshtojnë, madje edhe kliçka si puna ime po e kundërshton fuqishëm, bashkë me Dritonin e selmanajve. Me një fjalë, e pati puna e Hashimit, pasi unë dhe Dritoni jemi kundër tij. Besa, Dritoni me këto kundërshtime u bë deputet, do me u ba edhe kryeplaku i fisit të LDK-së, e unë ...?! Hashimi e ka një të mirë, me para të dërzhavës i paqëson të gjithë ata që e luftojnë. Alma e shau, u bë ambasadore. Gita e shau, u bë me terminal. Tafa e shau, djali u bë me terminal. Nipi i "Heroit të Kombit" e shau, u bë konsull. Denoncuesi i shokëve të vet, u bë këshilltar. Bashkimi, u shkarkua nga Hashimi, tash këshilltar. Agroni luante me dy palë letra, u shkarkua dhe pas e ka Gardën e Lekë Lumezit. Driton gylenisti u shkarkua, po bëhet sekretar! Rugovistët biologjikë dhe të adoptuar u rreshtuan para tij në radhë për t'ua varë nga një znaçkë rreth qafës. Gazetari e shau, u bë ambasador. Unë e lavdërova, u bëra ...mos të them çka. I pata thënë më herët, në hajgare Bacës Adem se ja, të gjithë shokët u veshën me pushtet dhe pozita e unë mbeta mbrojtës i minoriteteve, kurse Baca e dha një përgjigje epike: "Mos je bërë merak për një zallogë të Hashimit, menjëherë ta gjuan një..." Ka shumë shembuj të tjerë shembullorë kur Hashimi i ka rehatuar të gjithë ata që e kanë kundërshtuar fuqishëm, për një grusht dollarësh, si në filmat e Serxho Leones apo shpageti vestern. Shpageti politika, shpageti politika. Shpageti Hashim. Po kush jam unë ta kundërshtoj Hashimin si kryenegociator kur e ka përkrahjen e autoriteteve intelektuale, morale, njerëzore, kombëtare, politike etj. që kanë krijuar emër në skenën ndërkombëtare dhe pa të cilët kjo skenë nuk funksionon sikur që janë Zenuni, Enveri, Ganimetja, Blerta, Behgjeti dhe shumë të tjerë?!! Keni kujdes, nëse për shkak të së kaluarës së Hashimit siç janë aktiviteti ilegal, angazhimi politik në baushtellë, e sidomos lufta për çlirim dhe shtetndërtim, jam i detyruar të duroj që Hashimi t'i vendosë këllqet apo mbetjet e tyre në tavolinë, mirëpo nuk kam asnjë detyrim të pranojë që Bekimi të vendosë diçka në tavolinë, që nuk i ka aktualisht dhe kurrë as që i ka pasur, goglat e dushkajës. Bekimi edhe më tutje po na dhunon me profecinë se Hashimi është i paracaktuar nga Zoti (Kushtetuta) që në çdo rrethanë të jetë në krye të negociatave, derisa ta bëjë punën krejt m..jaltë! Bekimo, Hashimin e kam dost, po ty nuk të kam as djalë të tezes. As nuk ke qenë në UÇK, as nuk je komandant, as nuk je veteran i luftës e as nuk e ke askënd në UÇK!!! Këto janë arsyet pse do të duroja dhe asnjërën nuk e plotëson! Baju pra, mos na dhuno me profecitë se Hashimi është i dërguari... i Trampit! E di se e ke një dashuri pasionante për Hashimin sikur që e kishte Kuasimodo ndaj bukuroshes së imagjinuar! Realiteti është krejtësisht ndryshe, Bekimo!

**Pse më mbeti hatri ndaj Begjë Pacollit:** Me Behgjet Pacollin e kemi thuaja një të kaluar të përbashkët kombëtare, politike dhe patriotike sikur që shumë jemi sakrifikuar për popullin që, thënë të drejtën, nuk po na njeh vuajtjet që i kemi kaluar për dekada të tëra. Që të dy e kemi dashtë fort Titon, madje më shumë se Azemi dhe Kaçusha. Unë kam bërë thuaj nëntë vjet burg, që janë të papërfillshme krahasuar me vuajtjet e një kurbetçari që zemra i bëhet shkrumb duke vuajtur për atdheun. Në kohën kur unë kam pushuar në burgjet e ish-Jugosllavisë, Begja ka vuajtur jashtë vendit dhe atdheut, në Gjermani dhe Zvicër, për fillim. Unë kam qenë në "atdheun" tim. I kuptoj vuajtjet e një kurbetçari që për vite të tëra është i privuar nga atdheu dhe në këtë kontekst përpiqem t'i ndaj vuajtjet dhe dhimbjen që i kishte Xhabir Zharku që u detyrua të qëndrojë gjashtë vjet jashtë Kosovës. Po, sigurisht, burgu im dhe i shokëve është i papërfillshëm me vuajtjet e Begjës dhe Xhabirit. Definitivisht, nuk mund të vuaj sa ata. Po arsyeja pse më ka mbetur hatri te miku im i madh, Behgjet Pacolli, që kohët e fundit po më quan vëlla e që as vëllezërit biologjikë nuk më thërrasin ashtu, është pse nuk më thirri në iftarin e organizuar në shtëpinë e tij modeste në Hajvali. Përveç se na lidhë njerëzillëku, morali dhe sidomos çështja kombëtare, edhe unë (më pak) kurse Begja (shumë më shumë) jemi besimtarë. Ku ka më mirë që muaji i Ramazanit të përfundojë me një iftar të përbashkët ku është elita diplomatike, politike, intelektuale dhe fetare e Kosovës?! Çfarë iftari, sikur në tregimet e 1001 netëve?! Tavolina të mbushura me të gjitha të mirat e botës; mishra, sallata, hurma, ëmbëlsira, verë franceze, italiane, të Rahovecit, Vranac, uiski skocez, shampanjë, birra çeke, holandeze dhe Desperados meksikane. Zot, o Zot, ka munguar vetëm edhe vallëzimi erotik, belly - dance. Jetë o jetë! Kurrë Begj nuk ta bëj hallall për këtë përjashtim, me mendjen që e kam do të ndihesha sikur Neroni, Imperatori i Romës. Unë Neroni, Hashimi Jul Cezari, a mund ta imagjinoni këtë?! Hallall, Begj, mos të qoftë!



## Bie numri i kërkesave për azil në BE

BRUKSEL, 19 QERSHOR - Sirianë të tjerë, afganë dhe pakistanezë kërkuan azil në Bashkimin Evropian vitin e kaluar, pavarësisht rënies së madhe të numrit të përgjithshëm të aplikuesve.
Zyra Evropiane për Mbështetjen e Azilit tha, në raportin vjetor, se numri i njerëzve që kanë kërkuar azil në 28 vende të Bashkimit Evropian, plus Norvegjinë dhe Zvicrën, ka rënë gati për gjysmë, krahasuar me vitin 2016. "Ndërkohë që në vitin 2016 janë regjistruar rreth 1.3 milion aplikacione për mbrojtje ndërkombëtare, numri i tyre ka rënë në rreth 730 000 më 2017", thuhet në raport.
Të dhënat paraprake për katër muajt e parë të këtij viti tregojnë se numri i aplikimeve është stabilizuar në një mesatare mujore prej më pak se 50 000. Sirianët vazhdojnë ta përbëjnë numrin më të madh të azilkërkuesve, duke u pasuar nga afganët, pakistanezët dhe iranianët.

# Strategjia e Trumpit për zgjedhjet e Kongresit, në nëntor

Presidenti amerikan Donald Trump shpreson se imazhet e përpjekjeve të tij diplomatike me Korenë e Veriut do t'i ndihmojnë republikanët ta ruajnë kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit

UASHINGTON, 19 QERSHOR - Presidenti Donald Trump pritet ta vërë theksin te forcimi i ekonomisë dhe përpjekjet diplomatike me Korenë e Veriut, gjatë fushatës për t'i mbështetur republikanët në zgjedhjet e Kongresit të këtij viti, ku përcaktohet fati i kontrollit të Senatit dhe Dhomës së Përfaqësuesve. Aktualisht ky kontroll është në duart e republikanëve dhe demokratët e opozitës pritet të fitojnë terren duke ia ndërlikuar atij shpresat për rizgjedhje në vitin 2020.
Donald Trumpi shpreson se imazhet e përpjekjeve të tij diplomatike me Korenë e Veriut do t'i ndihmojnë republikanët që të ruajnë kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit. "Por Kina ka bërë një punë të mrekullueshme. Edhe president Xi dhe presidenti Moon. Të gjithë po bashkëpunojmë falë meje", tha ai.
Por ditët e fundit vëmendja është zhvendosur tek kufiri jugor i Shteteve të Bashkuara dhe protestat kundër politikës për "tolerancë zero" së administratës ndaj imigracionit të paligjshëm, që përfshin ndarjen e fëmijëve nga prindërit.
Demokratët si kongresisti Jerrod Nadler po ngrenë zërin. Thonë se këto janë gabimet e një administrate që flet në emrin tonë, por së cilës i mungon një kompas moral.
Sekretarja e Sigurisë Kombëtare, Kirstjen Nielsen, po e mbron këtë qëndrim. "Ne duhet ta bëjmë punën tonë. Nuk do të kërkojmë ndjesë se po bëjmë punën tonë", tha ajo.



Trumpi është ndoshta në qendër të fushatës për zgjedhjet e Kongresit këtë vit dhe kandidat republikan si Katie Arrington në Karolinën e Jugut, e mbështesin atë pa rezerva.
Por disa republikanë paralajmërojnë kundër kultit të individit të presidentit, përfshirë senatorin që po del në pension, Bob Corker. "Nuk është e shëndetshme për asnjë parti që të përfundojë me një situatë kulti individi për sa i takon presidentit", tha ai.
Mbështetja e ulët në sondazhe për presidentin Trump është rritur së fundmi, por pozita e tij vazhdon të jetë politikisht e luhatshme. Ndërsa afrohen zgjedhjet e Kongresit, thotë eksperti i sondazheve, Frank Newport. "Shifrat për mbështetjen e Trumpit nuk janë pozitive. Çdo president do që të ketë mbi 50 për qind miratim dhe për Trumpin është 42, 43 për qind. Megjithatë, këto shifra nuk janë shumë të ndryshme nga ato të disa presidentëve, një vit pas marrjes së detyrës", tha ai.
Presidentët Ronald Reagan, Bill Clinton dhe Barack Obama pësuan humbje në zgjedhjet e mesit të mandatit në mandatin e tyre të parë, një prirje që mund të vazhdojë edhe për Trumpin, thotë analisti Bill Galston. "Duket se demokratët janë më entuziastë për zgjedhjet e këtij viti sesa republikanët. Gjithashtu, historikisht, partia e presidentit humbet terren në zgjedhjet që mbahen dy vjet pas zgjedhjes", tha Galston.
Trumpi pritet t'i përqendrojë përpjekjet për ta rritur mirëqenien në vend dhe paqen në arenën ndërkombëtare, ndërsa përpiqet t'i ndihmojë republikanët dhe veten në nëntor.

# Çarmatimi bërthamor i Koresë së Veriut




SEUL, 19 QERSHOR - Zyrtarët ushtarakë amerikanë dhe ata koreanë-jugorë kanë rënë dakord t'i anulojnë manovrat ushtarake të caktuara për muajin gusht. Zëdhënësi i Ministrisë së Mbrojtjes së Koresë së Jugut tha të martën se aktualisht po presin një reagim nga Koreja e Veriut.
Presidenti Donald Trump tha se ishte ideja e tij anulimi i atyre që ai i quan "lojëra luftarake", ndërsa Uashingtoni dhe Pheniani angazhohen në negociata të besimit të mirë për ta zbatuar marrëveshjen e arritur në Singapor mes tij dhe udhëheqësit Kim, për çarmatimin bërthamor. Seuli thotë se manovrat e përbashkëta janë të rëndësishme dhe se stërvitje të tjera të mëvonshme mbeten një mundësi. "Koreja e Jugut dhe Amerika do të vazhdojnë të diskutojnë masa të mëtejshme, ndërsa ende nuk janë marrë vendime për stërvitje të tjera të mëvonshme", tha Choi Hyun-Soo, zëdhënës i Ministrisë së Mbrojtjes së Koresë së Jugut.
Presidenti jug-korean Moon Jaein ka kërkuar bashkëpunim për këtë çështje, ndërsa theksoi nevojën për të qenë të gatshëm për ta zbutur presionin ushtarak ndaj Koresë së Veriut nëse ka përparime drejt çarmatimit bërthamor. Ndërkohë, Pentagoni ka thënë se do të vazhdojë stërvitjet ushtarake në Paqësor me vende të tjera.

## Rusia do të hakmerret kundër tarifave tregtare të ShBA-së

MOSKË, 19 QERSHOR - Ministri rus i Ekonomisë, Maksim Oreshkin, ka thënë se Moska do të hakmerret kundër Shteteve të Bashkuara për tarifat e vëna në importet e çelikut dhe aluminit. Oreshkin ka thënë, në një deklaratë për media, se tarifat shtesë do të prekin produkte të ndryshme amerikane. "Rusia është duke shfrytëzuar të drejtat e saj në Organizatën Botërore të Tregtisë andaj po prezanton masa balancuese në importet që vijnë nga Shtetet e Bashkuara", është cituar të ketë thënë ministri rus.
Ai nuk ka përmendur llojin e importeve, mirëpo ka thënë se veprimet do të përfshijë masa që janë të barabarta me produktet e prekura, në mënyrë që të mos dëmtohet ekonomia ruse. Lista e produkteve amerikane që do të jenë cak i tarifave ruse do të bëhet publike javën e ardhshme, ka njoftuar ministria.
Uashingtoni ka vënë tarifa 25 për qind në çelik dhe 10 për qind në alumin në muajin mars, duke cituar arsye të sigurisë kombëtare. Shtëpia e Bardhë pati njoftuar se masa synon t'i kufizojë importet nga Kina.



# Ëndrra duhet ta paguajë tagrin e vet

(Për Mustafa Nanon dhe dëshirën e tij që shqiptarët një ditë t'i shikonin serbët ashtu si shohin italianët)



Bedri Zenel ISLAMI

Mirëdita, Mustafa!
Shumë vjet më parë, një ndër politikanët dhe filozofët më të shquar shqiptar të shekullit të shkuar, Ukshin Hoti, në janarin e vitit 1992, në dyvjetorin e vrasjeve që kishin ndodhur në fshatin Brestovc, do të shkruante lidhur me temën e fundit në dialogun tuaj me gazetarin serb Zoran Panoviç, pra dëshirën tuaj, që në vetvete është e natyrshme, që shqiptarët të shkonin aq mirë me serbët, sa shkonin edhe me italianët, "Shpirti i shqetësuar kishte konstatuar me hidhërim: "Si ka mundësi vallë që mendja e njeriut të zbresë në nivelin e bishave?"
Nuk e kam njohur Ukshin Hotin, nuk e kam takuar kurrë. Kam njohur disa nga miqtë më të afërt të tij, disa nga të cilët më pas u bënë heronjtë e Kosovës. Ukshin Hoti ishte një njeri me shpirt të gjerë, jashtëzakonisht human, i cili kishte kaluar jetën në dy rrugë krejtësisht të ndryshme, njëra nga të cilat do të ishte edhe fundi i tij: nëpër bibliotekat e botës, ku ishte ngulur gjatë në sallat dhe auditorët e Harvardit, më shumë si mësimdhënës dhe, tjetra, në burgjet serbe.
Kishte qenë i burgosuri politik më i njohur shqiptar për vetë pozitën dhe mendjen e tij. E vranë po atë ditë që e nxorën nga burgu, e menduan djallëzisht zhdukjen e tij, gjithçka e planifikuar deri në detaje. Ukshin Hoti e kishte pritur vdekjen, ndaj kishte ndërtuar jetën e tij.
Vinte nga Krusha e Vogël, ngjitur me Krushën e Madhe. Krusha e vogël, vendlindja e Ukshin Hotit, kishte para luftës 856 banorë. Në dy ditë, 25 dhe 26 mars 1999,forcat ushtarake, policore dhe paraushtarake serbe vranë në këtë fshat pa asnjë mëshirë 112 meshkuj. Në këtë fshat sot jetojnë 82 gra të veja me 145 fëmijë jetimë, ndërsa 10 familje nuk kanë asnjë mashkull. Nga 145 shtëpi para luftës, vetëm 8 prej tyre kanë shpëtuar pjesërisht nga djegia. Një kamion me kufomat e burrave të Krushës së Vogël u dogj në bregun e Drinit të Bardhë.
E gjithë kjo vetëm në dy ditë.
Pak më tej Krushës së Vogël është Krusha e Madhe. Rruga gjarpëron përmes pemëve dhe ende, sapo të shfaqet fshati i madh mund të dallosh se lufta ka qenë e pranishme. Edhe pse kanë shkuar 19 vite. Në tri ditë, 25 deri 27 mars 1999, forcat serbe vranë 243 njerëz; pa asnjë dhimbje i qëllonin ku i shihnin, i gjuanin sikur të ishin njerëz të egër, gajaseshin, merrnin nëpër këmbë të plagosurit rëndë që po vdisnin, e më pas, kur ishin lodhur nga vrasjet, i digjnin trupat e tyre. 64 trupa nuk janë gjetur kurrë.
Përpiqem t'i them miqve të mi në Krushë të Vogël e në Krushë të Madhe se, ku ta dish, ndoshta një ditë, dëshira e një gazetari shqiptar, që nuk e di se si e ka shijuar luftën, për të qenë miq me serbët, po aq miq sa edhe me italianët mund të jetë një realitet, por u dukem sikur vij nga një botë tjetër, sikur nuk jam në vete; pezmi i tyre rri ende mbi vatrat, mbi jetën, të ngjeth shtatin dhe të bën të ndjehesh tjetërsoj.
Në Krushë të Vogël, krahas policisë dhe ushtrisë serbe, u armatosën edhe fqinjët serbë, njerëz që kishin vaditur së bashku, kishin folur e jetuar së bashku dhe ata, të djeshmit, normalë, deri diku njerëzorë, vendosën flakët në shtëpitë e fqinjëve të tyre, me të cilët kishin ndarë shumëçka dhe kurrë nuk e kishin pasur një të keqe prej tyre.
I them vetes se , ku ta dish, një gazetar nga Shqipëria, i njohur tepër, disi i veçantë në llojin e tij dhe gjithnjë me të papriturën e fjalës, di diçka më shumë se të tjerët. Përpiqem të ia shpjegoj një familje në Suharekë: quhet familja Berisha. Ngulmoj të heq një pjesë të dhimbjes së tyre, por fjalët nuk i kam të mbaruara; trembem kur mendoj se vetëm në një ditë, përsëri me 25 mars 1999, nga kjo shtëpi u vranë 51 vetë. Është e vetmja masakër në Kosovë që ka katër të dënuar ushtarakë të lartë serbë, Radojko Repanoviç, Mirosllav Petkoviq, Milorad Nisheviç dhe Sllagjan Qukaviç; por ata nuk ishin të vetmit. Të tjerët u falën; shpejt edhe këto do të jenë të lirë.
Në një ditë të tillë, fund marsi të vitit 1999, isha në shtëpinë e një mikut tim të vjetër. Quhet Gani Lipaj, mjek nga profesioni. Jeton në Mynih. Në të vërtetë shkova ta uroj për bijën e tij, e cila ishte shpallur kampione në tenis për moshat e saj në Bavari. Ishte pasdite dhe ndoqëm sëbashku lajmet. Spikeri po lexonte: Në fshatin Kaminecë, afër Banjës së Pejës, dje ndodhi një masakër e përbindshme. Ganiu luajti pak dhe tha, "ky është fshati im. Spikeri vazhdoi, ndërsa korrespondentët e luftës kishin dërguar pamjet. Ganiu mbeti dhe tha: Kjo është shtëpia ime. Spikeri vazhdoi: forcat ushtarake serbe masakruan familjen Lipa. Ganiu mbeti: Familja ime, më tha dhe u ul. Së bashku me ne, në atë moment , ai shikoi se si po nxirrnin nga pusi i shtëpisë kufomat e babait, vëllait, gruas së vëllait, nipave dhe mbesave.
Ndoshta më duhet një ditë t'i them atij se, ja, njerëzit modernë, që ushqehen në Tiranë, mendojnë se do të ishte mirë të jemi me serbët , ashtu si jemi me italianët. Nuk e di nëse do të më kuptojë. Kemi mbi 20 vite miqësi, por sytë i kam edhe sot me atë pamje makabër, kur një njeri i paqtë, shikonte se si nxirreshin nga pusi kufomat e njerëzve të tij më të afërt.
Askush deri më tani nuk i ka thënë Gani Lipes, të paktën njerëzisht, më fal, më fal se të shkretuam familjen. Askush. Atij i duhet të jetojë me dhimbjen e humbjes, edhe pse ata, vrasësit, ende nuk e dinë se cilët vranë. Sepse ata vranë pa emër, ashtu, për qejf, vetëm se ishin shqiptarë dhe se, prej kohësh, jo vetëm në luftën e fundit, për to, një shqiptar i mirë, është një shqiptar i vdekur.
Në Kosovë jeton një mjeke e shquar, humaniste e shkallës më të lartë, poete dhe deputete, ish e burgosur politike. Quhet Teuta Hadri. Mbesa e Ali Hadrit, akademikut të njohur. Ajo ka shkruar një libër dy vëllimesh, "Krimi që pashë me sytë e mi", pasi që nga dita e parë ishte mjeke në UÇK. Është libri më autentik dhe më tronditës që mund të lexojë një njeri, pikërisht për krimin që ajo pa me sytë e saj, duke i shpëtuar vdekjes mrekullisht. Në asnjë rresht të më se 900 faqeve të librit të saj nuk ka një fjalë mallkimi për serbët; të duket sikur ajo ka qenë vëzhguese e jashtme, pa mllef, pa urrejtje. Por në faqet e librit është dëshmia e krimit. Vetëm në një ditë, me 27 prill 1999, forcat serbe, ushtarake e policore, së bashku me serbët që banonin në Kosovë si paraushtarakë, vranë, në atë që tash njihet si Masakra e Mejës, 377 shqiptarë, shumica nga Kosova. Në një ditë. Në një vend. Si i morën plumbat. Qëllo e qesh.
Nejse. Të solla shumë shembuj, të cilat, besoj, se edhe Ti, si një gazetar i njohur, i di. Mos u habit nëse them vetëm " besoj". Ka shumë kolegë që as nuk e dinë se çfarë ka ndodhur në Kosovë. Ata njohin vetëm një emër, Adem Jasharin; një masakër, të Prekazit, por pak dinë për të tjera masakra edhe më të mëdha.
Është lehtë të ëndërrosh që, një ditë, shqiptarët të shkojnë me serbët ashtu si shkojnë sot me italianët. Një ëndërr e pakushtueshme, e aq më tepër mikluese. Të duket si një projekt i së ardhmes. Një sfidë ballkanike që mund të nisë edhe nga dialogu juaj me kolegun serb. Dialogu është i këndshëm, nganjëherë edhe i dobishëm. Serbët, kur nuk kanë mundësi tjetër, i kanë qejf dialogjet. Çfarë humbin në luftë, e fitojnë në paqe, sepse mendojnë përsëri për luftën. Mentalitet apo mënyrë jetese? As ata vetë nuk e dinë. Sapo u ngrihet paksa koka nga zhgënjimi i humbjes, gjëja e parë që mendojnë është revanshi.
Të dialogosh është kënaqësi, aq më tepër kur nuk bart asgjë nga e shkuara. Nuk ke asnjë kujtim prej saj dhe asgjë nuk të dhëmb. Si të shkrova, serbët e duan dialogun pas humbjes. E kanë dashur gjithnjë.
Jam munduar shpesh herë të di se nga vjen ky mentalitet i tyre, kaq herë i përgjakshëm dhe po kaq herë i pa mbushur në mend. I kam parë fillimisht serbët, pas marsit të vitit 1998, se si rrinin të hutuar dhe me droje në shtëpitë e tyre në perëndim. Kishin droje se mos shqiptarët, që jetonin në Zvicër apo në Gjermani, duke parë se si po vriten njerëzit e tyre, jo pak, por rreth 13 mijë vetë në 13 muaj luftë, do të hakmerreshin mbi to.
Ndoshta nuk e di, por asnjë gonxhe lule, asnjë degë peme , asnjë tjegull çatie nuk u është prishur. Shqiptarët, edhe në këtë dhimbje, u dëshmuan humanë dhe të arsyeshëm. Bënë një ndarje, të cilën, ende, edhe sot, nuk e ka ndarë kolegu juaj, përtej Kosovës, por që, nuk e di pse jam i bindur, ëndërron Kosovën.
Ruajna Zot! të më shkojë në mendje se nuk duhen dialogjet, nuk duhen bisedat. Ata janë të mira, por një ëndërr ka gjithnjë një fillesë: një ndjesë, qoftë edhe përmes një gazetari, një njeriu human, si Natasha Kandiq; duhet të burojë përsëri ajo ndjenjë njerëzore që nuk shfaqet.
Si ju shkrova, më ka munduar shpesh herë kjo ndarje ballkanike, kaq e egër; kjo ndjenjë serbe për të ndjekur krimin. Po i kthehem Ukshin Hotit, njeriu që më mirë se gjithë të tjerët e ka njohur botën, psikologjinë e tyre, por që kurrë, edhe pak çaste para se ta vrisnin, nuk i ka urryer.
"Serbët i kishin shquar veçoritë e shqiptarëve si popull, por në vend që t'i respektonin, në vend që të ndërtonin urat e miqësisë së ndërsjellë, për gati 80 vite kishin rënë në kurthin e imitimit të madhësisë së të mëdhenjve. Ata e vazhduan dramën e tyre me veten dhe i thelluan humnerat me shqiptarët, i lartësuan hendeqet dhe i zgjeruan kanalet me ujë të ndotur të izolimit të vetes. Ata natyrisht e dinin se kjo ishte politikë e dështimit dhe jo e vetëbesimit, refleksion i dëshpërimit dhe jo i perspektivës, rezultat i lajthitjes dhe jo i vërtetësisë, e përmbytjes dhe jo e shpëtimit. Vetëm se nuk e dinin se përse e bënin një gjë të tillë".
Do të jetë e vështirë të bëhet kaq shpejt e vërtetë një ëndërr si e jotja.
Nëse italianët, edhe kur ishin pushtues, u shfaqën si pushtuesit më njerëzorë, në të kundërtën, serbët, edhe kur erdhën si miq, ishin më gjakosorët.
Italianët kur ikën lanë pas vetes edhe krimet e tyre,por edhe disa godina e ura që mund të trajtoheshin si fillesë e një miqësie të ardhshme; në të kundërtën, serbët, edhe kur u ftuan për dasmë , lanë pas vetes urat e zjarrit, lëre pastaj kur erdhën si ushtri. Lanë shkretim.
E dua fort ëndrrën tënde, por e di fare mirë se nuk do të jem kur ajo të fillojë të gjejë një vend ndriçues. Sepse mungon, edhe sot, pas 20 vjetëve, e para e së parës: fjala e faljes.

E rrallë

## Shtatë ditë pas martesës zbulon që gruaja e tij ka mjekër



Një burrë indian ka kërkuar divorcin nga gruaja pasi ka zbuluar se ajo kishte mjekër dhe fliste si burrë. Ai ka thënë se nuk e kishte parë fytyrën e gruas përpara dasmës sepse ajo mbante mbulesë. Ai nuk i ka folur asaj sepse ceremonia u bë sipas zakonit.

FOTO E DITES




Banorët ecin në vendbanimin e përmbytur të lagjes Mawlamyine të Myanmarit. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Ngordh orangutangu më i vjetër në botë



Orangutangu më i vjetër në botë, i llojit Sumatran orangutang, ka ngordhur në kopshtin zoologjik të Australisë, në moshën 62-vjeçare, duke lënë pas 54 pasardhës, raporton "BBC". Puan, kështu quhej orangutangu, është përshkruar si 'zonja e vjetër' e kopshtit zoologjik në Perth dhe iu injektua një gjilpërë për të ngordhur si shkak i komplikimeve të lidhura me moshën e vjetër.

## BARSOLETA E DITËS



- Më fal, a bën një mbushje?
- Po, ku me ta dërgu?
- Në telefonin tem.
- O ti djalë, po a në 'Vala' a në 'Ipko',

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo







**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson

**Në ora 16:00 dhe 20:00**

### "DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

**Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.**







**Në ora 22:00**

### "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot planetët i keni në anën tuaj dhe ju premtojnë një fillimjavë të mbarë. Gjithsesi ju duhet të lini më shumë hapësirë për jetën familjare.



**DEMI**
Një dëshirë e madhe për normalitet dhe për projekte konkrete. Ka ardhur momenti të mendoni një zgjidhje më të përshtatshme për veten tuaj.



**BINJAKËT**
Çdo dëshirë e juaja është një urdhër në këtë periudhë. Thjesht, duhet ta përmirësoni disi mënyrën e të kërkuarit të gjërave.



**GAFORRJA**
Keni lënë shumë gjëra pezull dhe nuk po gjeni dot mënyrën për t'u organizuar. E gjithë kjo situatë do t'ju penalizojë.



**LUANI**
Çastet e vogla të kënaqësisë sot janë ato që do ta bëjnë diferencën në rutinën e ditës dhe do t'ju japin energji pozitive.



**VIRGJËRESHA**
Nuk dini të gënjeni kështu që gjatë drekës duhet t'u jepni përgjigje të sakta personave që do të kërkojnë informacion nga ju.



**PESHORJA**
Keni çështje burokratike ose administrative për të zgjidhur sot. Mos humbni kohë duke kërkuar zgjidhje vërdallë, e dini se çfarë duhet të bëni.



**AKREPI**
Eprorët tuaj kanë filluar të dyshojnë nëse jeni vërtet i aftë ta bëni punën, kjo si pasojë e disa vonesave të vërejtura kohët e fundit.



**SHIGJETARI**
Ndryshojeni ritmin e ditës duke organizuar një takim me miqtë, një film në kinema ose diçka tjetër të këndshme.



**BRICJAPI**
Mposhteni shumë shpejt nga emocionet dhe kjo gjë nuk ju lejon ta shihni realitetin që ju ofrohet. Duhet të logjikoni në mënyrë racionale.



**UJORI**
Personat që ju kanë pezmatuar do t'i nxirrni përfundimisht nga jeta juaj. Jeni drastike në marrjen e vendimeve, por kjo ndodh veç kur lëndoheni.



**PESHQIT**
Sot do ta keni mundësinë të ballafaqoheni me një person me të cilin keni debate të vazhdueshme. Do të sqaroni shumë gjëra.

# Heidi Klumi, e lumtur me të dashurin 28-vjeçar




Që prej muajit mars Heidi Klumi po shijon romancën me të dashurin e saj 17 vjet më të vogël. Duket se ata po kalojnë një periudhë të mrekullueshme së bashku. 45-vjeçarja është fotografuar me të dashurin e saj 28-vjeçar Tom Kaulitz në Disneyland. Në këtë udhëtim Klum shoqërohej edhe nga fëmijët.

# Dua ua tregon gishtin paparacëve




Këngëtarja me famë botërore Dua Lipa është treguar pak e vrazhdë kur ua ka drejtuar paparacëve gishtin e mesit, pasi atë e kanë fotografuar gjatë gjithë kohës derisa ajo po ecte me të dashurin Isaac Carew. Ditë më parë ishte raportuar se Isaac e kishte tradhtuar Duan, por ai përmes një postimi në profilin e vet në "Instagram" ka pohuar se nuk duhet besuar gjithçka që shihni.



# Rita Ora, si Marilyn Monroe

Rita Ora është e njohur për stilin unik, por këngëtarja me origjinë shqiptare ka imituar aktoren ikonë të viteve 1950, Marilyn Monroe. Ylli i popit po ecte rrugëve të Nju Jorkut kur filloi një erë e lehtë dhe bëri që fundi i saj të ngrihej, njësoj si ai në rastin e Marilynit. Rita gjithmonë ka befasuar me stilin e veshjes dhe këtë herë nuk zhgënjeu.

# Vritet në moshën 20-vjeçare reperi i famshëm



Reperi amerikan XXXTentacion, i cili u bë i famshëm falë dy albumeve hit të njëpasnjëshme, është vrarë në moshën 20-vjeçare. Ngjarja ka ndodhur në jug të Floridës, ditën e hënë, kur një person e ka qëlluar me armë zjarri. Policia thotë se XXXTentacion, emri i vërtetë i të cilit është Jahseh Onfroy, u dërgua në spital përpara se të ndërronte jetë. 20-vjeçari ishte një artist që gjithmonë u rrethua nga polemika gjatë karrierës së tij të shkurtër dhe aktualisht po përballej me akuza për dhunë në familje.

# Oskar Wilde, letrat e dashurisë për poetin 20-vjeçar



Historitë e dashurive nuk janë asnjëherë të lehta, aq më tepër të atyre që janë të të njëjtit seks. Një ndër personazhet që e ka vuajtur më shumë persekutimin për shkak të prirjeve të tij dashurore është Oskar Wilde, i cili u burgos disa herë për homoseksualizmin e tij. Por pavarësisht vuajtjeve, historitë e tij të dashurisë janë ndër më të bukurat.

Në qershor të vitit 1891 ai u takua me Lord Alfred "Bosie" Douglas, poet i ri 21 vjeçar që studionte në Oksford, që do të kthehej më pas në muzën e Wilde për të shkruar "Portretin e DorianGrayt". Gjatë kohës që jetuan së bashku, Oskar shkroi veprat themeltare të krijimtarisë së tij. Janë pafund letrat e dashurisë që ata i dërgonin njëri tjetrit, duke u konsideruar si ndër letrat më të ndjera në historinë e çifteve e njohura të artit. Xxx Një letër e shkruar një ditë të ftohtë nëntori, Oksford 1892 nga Wilde: I dashur Bosie …

Do doja shumë të shkoja diku me ty larg, aty ku është ngrohtë e plot ngjyra… Disa javë më vonë, në janar 1893 Wilde shkruan: Djaloshi im, Soneti që më dërgove ishte i bukur, gati një mrekulli sesi buzët e kuqe të gjetheve të trëndafilave, mund të çojnë në çmendinë e muzikës dhe të puthjes. Shpirti yt i hollë i mbështjellë nga pasioni ecën lehtë drejt poezisë. Pse jeni vetëm në Londër dhe kur do të shkosh në Salibury? Apo do të ftohësh duart në muzg…Këtu është një vend i bukur, por më mungon ti…

Me një dashuri të pavdekshme, i joti Oscar Në fillim të marsit 1893, Wilde shkruan një letër ku ndjehet padurimi i dashurisë I dashuri i të gjithë djemve! Letrat jote ishte e këndshme. Verë e kuqe dhe e bardhë për mua…Por jam i trishtuar. Nuk duhet të bësh skena me mua, ato më trishtojnë, më rrënojnë. Unë ju shoh si një krijesë që ke dalë nga antikiteti grek, dhe s'mundt'ju shoh tëështrembëruar nga pasioni. S'mund ti dëgjoj buzët e tua të buta të thonë gjëra tëkëqija për mua. Mos e thyej zemrën time.

Ndjej se duhet të shoh sa më shpejt. Do të vij nëSalisbury. Nuk e di si do t'ja bëj. Je diçka hyjnore për mua. Këtu ku jam ka shumë vështirësi. Fatura ime shkon £ 49 për një javë! Tashmë jam ulur në një stol pranëThames – por ju, nuk jeni këtui dashuri im, djali im i mrekullueshëm… Gjithmonë yti Oscar Dashuria e tyre nuk ishte e lehtë dhe për shkak të kushteve ekonomike. Në një letër të dhjetorit të vitit 1893 Wilde i shkruan: Djali im i dashur, Faleminderit për letrën tuaj. Jam i mbingarkuar nga presionet e kreditorëve aq sa duket se jam buzë greminës por ndjehem i lumtur që jemi sërish miq, dhe se dashuria jonë ka mundur të sfidojë hijen për të mbetur mes dritës, ashtu si një trëndafil i vjetër.

Le të jemi gjithmonë të dashur për njëri-tjetrin, siç kemi qenë gjithmonë. Mendoj për ty çdo ditë e më shumë… Oskar Në qershor të atij viti Wilde shkruan: I dashuri im i shtrenjtë! Shpresoj që cigaret të kenë ardhur të gjitha. Drekova sot me Gladys de Grey, dhe dy të tjerë këtu. Ata më ftuan të shkoj në Paris me ta të mërkurën, por ti e di nuk kam shumë para të udhëtoj. Më ka marrë malli dhe dua të shoh.

Është absurde por nuk mund të jetoj pa ty. Ti je shumë i dashur, i mrekullueshëm…Mendoj për ty gjithë ditën, më mungon lëkura jote, duket sikur lëviz duart në ajër dhe të ndjej…E di që nuk më beson, por në janar të premtoj do ikim bashkë larg, në një udhëtim të gjatë, ku duart e tua të jenë gjithë kohën pranë meje. Do jetë një kohë e bukur djalosh, aq sa do të duam të mos mbarojë. Të dy e meritojmë këtë arratisje. Më shkruaj, ma ndrysho këtë vetmi I joti përgjithmonë Oskar. *gazeta-Shqip.com)*

# Kur përfundon një dashuri, 3 strategji për zemrat e thyera

**Shpërqendrimi, mendimi i anëve negative të ish-it dhe rivlerësimi i dashurisë**



"Tani nuk e dua më, është e sigurt, por sa shumë e doja … nuk e dua më, ajo është e sigurt, por ndoshta e dua". Në këto vargje të poetit Pablo Neruda ka një përzierje të ndjenjave në të cilat e gjejnë veten ata që e kanë zemrën e thyer nga fundi i një dashurie. Para së gjithash vështirësia është të harrosh.

Por ka strategji për t'u kthyer, të paktën në afat të shkurtër, dhe tani edhe shkenca ndihmon, gjë që ka identifikuar tre që duket se janë efektive. Para së gjithash (më intuitive) shkëpusni vetveten, mendoni për diçka që na bën të ndihemi mirë dhe mendoni për partnerin që është thjesht një i huaj. Pastaj, mendoni për aspektet negative që lidhen me ishin tuaj (një zakon që konsiderohet veçanërisht i bezdisshëm) dhe më në fund rivlerësimi i dashurisë: pastaj bindni veten për afirmimet si "është e drejtë të duash dikë me të cilin nuk jam më bashkë", me pak fjalë, e "shoqëroni" ndjenjën në vend se ta kundërshtoni atë.

Të tre këto strategji u propozuan në një studim të udhëhequr nga Sandra Langeslag, drejtoreshë e Njohurisë së Emocionit dhe Motivimit të Universitetit të Missouri-St. Louis, për 24 vetë, të moshës 20 deri në 37 vjeç, të cilët kishin një marrëdhënie në afat të gjatë që kishte përfunduar, mesatarisht dy vjet e gjysmë.

Pjesëmarrësit u ndanë në katër grupe, një për secilën strategji, plus një e fundit, dhe rezultatet u botuan në Journal of Experimental Psychology: pas zbatimit të tyre, kur fotografitë e tyre ishin treguar për pjesëmarrësit, duke matur intensitetin e emocioneve të regjistruara përmes elektrodave dhe një pyetësori, në të tre rastet përgjigjja emocionale ndaj fotove u zvogëlua. Por, me dallime: nëse rivlerësimi negativ ndaj ishit pakësonte ndjenjat e dashurisë, por nuk i bënte ata të lumtur, shpërqendrimi nuk ndryshoi ndjenjat, por i bëri pjesëmarrësit më shumë të kënaqur. *(gazeta-Shqip.com)*

# Makinat ekstravagante të 5 udhëheqësve të botës


1

Mbretëresha Elizabeth II lëviz në Bentley, Putini preferon një Aurus Aurus Limousine. Dhe Papa Françesku kishte makinën e paraardhësit të tij në garazh. Njihuni me makinat që ekstravagante të liderëve më të mëdhenj të botës.

### 1. 'Bentley Limousine' – Mbretëresha Elizabeta II

E projektuar posaçërisht për Jubileun e Artë të vitit 2002, Bentley Limousine i pëlqeu shumë Mbretëreshës Elizabeta II që donte të porosiste një tjetër menjëherë, pavarësisht kostos jo saktësisht brenda mundësive të njerëzve të zakonshëm:
Siç është zbuluar nga faqja e internetit Select Car Leasing, makina luksoze e blinduar plotësisht kushton 14.7 milionë dollarë (të barabartë me 12.4 milionë euro). Veçantitë e tjera të Bentley janë çatia panoramike me shikueshmëri më të madhe nga jashtë dhe dyert që hapen në 90 gradë, për të lejuar që Madhëria e Tij të dalë nga makina "në një mënyrë dinjitoze".

### 2. 'Cadillac One' – Donald Trump

I nominuar "The Beast", Cadillac One Donald Trump i presidentit amerikan është një kala e lëvizshme prej 1.6 milionë dollarësh (1.35 milionë euro): përveç dritareve të hapura anti-plumbash dhe dyerve të blinduara 12 centimetra dhe 20 centimetra të trasha, armë me gaz lotsjellës dhe një aparat për vizion natën u fshehën gjithashtu në pjesën e përparme të makinës. "Makina është një Cadillac vetëm në emër – pranoi një burim për Autoëeek – sepse edhe stemat janë ndryshuar dhe në fakt është në thelb një kamion që duket si një limo".

### 3. Mercedes-Benz S600 (W221) Pullman Garda – Kim Jong Un

Fotoja e 12 truprojeve (të gjitha të zgjedhura në bazë të pamjes fizike dhe aftësive të tyre nga rekrutët e ushtrisë) të cilët punojnë së bashku me Mercedes Limousine të Kim Jong Un ka bërë raundet e rrjetit. Sa për veturën, është një model shumë masiv, mbi 6 metra i gjatë dhe i aftë të përballojë një sulm me granata, si dhe plumba: e gjithë kjo, së bashku me modifikimet e veçanta të kërkuara nga diktatori i Koresë së Veriut, kanë shkaktuar që kostoja finale e Mercedes Benz S Class të rritet në 1.6 milion dollarë (1.35 milion euro).

### 4. 'Aurus Senat Limousine' – Vladimir Putin

Pas rizgjedhjes për mandatin e tij të katërt, Presidentit rus Vladimir Putin i është dhuruar një limuzinë e re prej 588,000 dollarësh (500,000 euro): lindur nga një ndërmarrje e përbashkët midis Porsche dhe institutit rus NAMI, Aurus Aurus është një kolos i blinduar 6 ton, i pajisur me pajisjet më të mira të komunikimit dhe me karakteristika të tjera emergjente.


4



2


3


5

### 5. 'Mercedes-Benz M-Class' – Papa Benedikti XVI

I quajtur me dashuri "Popemobile", në të vërtetë makina e blinduar me vlerë 535,000 dollarë (450,000 euro) e përdorur nga papën Benedikti XVI gjatë papatit të tij me rastin e ngjarjeve publike ishte e fundit që u quajt ashtu, sepse Papa i tanishëm në vend të kësaj preferon të lëvizë në bordin e makinave më të matura.

*(gazeta-Shqip.com)*




# Sport




PROGNOZA SPORTIVE

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| URUGUAY - SAUDI ARABIA | 1 | IRAN - SPAIN | 2 | PORTUGAL - MOROCCO | 1 |

# Mbahen konsultime me klubet e femrave për reformimin e ligës

Kryetarja e Komisionit për Futbollin e Femrave, Vjollcë Krasniqi, ka thënë se ka indikacione që këtë vit do të shtohen edhe disa klube. "Duhet të mendojmë të krijojmë dy liga qysh nga ky kampionat dhe me këtë do të kemi një superligë shumë më konkurruese", ka thënë Krasniqi në takimin konsultativ me përfaqësuesit e klubeve të femrave. Pas këtij takimi u vendos që secili klub të deklarohet me shkrim për formimin e dy ligave

"Epoka e re"



**Prishtinë, 19 qershor** - Me qëllim të konsolidimit të ligës së femrave në të cilën aktualisht garojnë 13 skuadra dhe gjatë kampionatit është vërejtur një dallim i madh në cilësi ndërmjet skuadrave, të martën është mbajtur një takim konsultativ me përfaqësuesit e klubeve të femrave. Duke i përshëndetur të pranishmit, anëtarja e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së dhe kryetare e Komisionit për Futbollin e Femrave, Vjollcë Krasniqi, ka thënë se ka indikacione që këtë vit do të shtohen edhe disa klube. "Duhet të mendojmë të krijojmë dy liga qysh nga ky kampionat dhe me këtë do të kemi një superligë shumë më konkurruese dhe një ligë të parë që do të ishin rivale të barabarta. Ju e dini se gjatë kampionatit të kaluar kishim disa fitore me dallim të madh të golave, që në njëfarë mënyre ato vajza që humbnin ndiheshin të lënduara, prandaj po kërkoj nga ju ta analizoni me qetësi reformimin e ligës dhe secili me shkrim ta sillni në FFK pajtueshmërinë", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se qëllimi është të rriten cilësia dhe konkurrenca ndërmjet klubeve të femrave.

Ndërkaq sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu, para përfaqësuesve të klubeve ka theksuar edhe një herë se futbolli i femrave është një nga prioritetet e FFK-së. "Ne do të vazhdojmë t'i mbështesim klubet e femrave në të gjitha format. Por, gjithsesi duhet gjetur rrugë dhe mënyrë që ta rrisim cilësinë", është shprehur Salihu.

Edhe përfaqësuesit e klubeve kanë dhënë mendimet e veta dhe në parim e kanë mbështetur këtë nismë, por kanë kërkuar kohë për konsultime. Në fund u vendos që secili klub do të deklarohet me shkrim për formimin e dy ligave.

# Feim Hoxha, sekretar i Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës në Sport

**Prishtinë, 19 qershor (ER)** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në bazë të Rregullores nr. 03/2018 për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive, ka nënshkruar vendimin për emërimin e Feim Hoxhës, sekretar i Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive.



Feim Hoxha, njëherësh udhëheqës i Departamentit Ligjor në MKRS, në rolin e sekretarit të Këshillit do të mbështesë dhe do të kujdeset për funksionimin administrativ të Këshillit. Ministri Gashi ka vlerësuar se me emërimin e sekretarit të Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Sport përmbushet edhe aspekti i fundit ligjor i funksionalizimit të këtij Këshilli, e cili do të ketë qëllim luftimin e dukurive negative në sportin e Kosovës.

# 'Logon e FFK-së e zgjodhi Fadil Vokrri'

**Prishtinë, 19 qershor** - Një numër simbolik i dizajnuesve dhe qytetarëve kanë protestuar të martën para selisë së Federatës së Futbollit të Kosovës, në shenjë pakënaqësie për logon e kësaj federate, e cila është zgjedhur ditë më parë. Jo më shumë se dhjetë persona me këtë rast shprehën pakënaqësinë për dizajnimin e logos, duke pretenduar se kjo logo nuk e ka merituar të zgjidhet. Ata kanë vendosur parullën "O dhëndër, u bonëm horë", duke ia kushtuar këtë disenjatorit të logos, i cili thuhet se është dhëndri i Diturie Hoxhës, drejtoreshës për Marketing në FFK.

Nënkryetari i FFK-së, Agim Ademi dhe sekretari i saj, Eroll Salihu, ua kanë shpjeguar protestuesve se si ka ardhur deri te kjo zgjedhje e logos. Sekretari i Federatës ka pohuar se kjo ka qenë një zgjedhje e ish-kryetarit tashmë të ndjerë të FFK-së, Fadil Vokrri, pasi atij i janë ofruar tri zgjedhjet përfundimtare. Pas kësaj, protestuesit mbajtën një takim brenda zyrave të FFK-së me drejtues të kësaj të fundit, në të cilin mediet nuk u lejuan të marrin pjesë. Pas takimit që zgjati rreth 20 minuta, Arben Lezi nga "Prishtina Designer" ka treguar se çfarë u tha nga drejtuesit e FFK-së, duke u pajtuar që kjo logo do të jetë së paku për dy vjet, pasi tanimë federata e ka dorëzuar atë në UEFA.

## Arbnor Morina, Isa Sadriu e Megzon Visoka marrin licencat Profi-level

**Prishtinë, 19 qershor** - Një nga prioritet e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) është ngritja profesionale e trajnerëve të futbollit, duke qenë se gjatë okupimit shumë trajnerë nuk e kishin mundësinë e ngritjes së tyre profesionale. Kështu që në bashkëpunim me FShF-në numrit të trajnerëve me licencën Profi-level tashmë i janë shtuar edhe tre trajnerë të futbollit. Përzgjedhësi i Kombëtares U-15, Isa Sadriu, trajneri i Kombëtares U-19 të femrave, Megzon Visoka dhe trajneri i mirënjohur Arbnor Morina janë tre trajnerët e pajisur së fundmi me licencën Profi-level.



## Shaqiri: Serbisë nuk ia kam frikën fare



BERN, 19 QERSHOR - Futbollisti Xherdan Shaqiri është optimist se përfaqësuesja e Zvicrës do të dalë mirë nga dy duelet e ardhshme ndaj Serbisë dhe Kosta Rikës, të vlefshme për Grupin E të Botërorit. Shaqiri ka paralajmëruar edhe një ndeshje të bukur për Zvicrën pas paraqitjes fantastike që kishte ndaj Brazilit. Ai ka thënë se nuk ia ka fare frikën Serbisë. "Presioni nuk është mbi ne. E kemi ndalur Brazilin dhe tani jem të etur për fitore. Serbisë nuk ia kam frikën fare. Besojmë në një rezultat pozitiv. Ne i dimë aftësitë dhe kualitetet tona. Kemi lojtarë të shkëlqyer që luajnë në ligat më të forta për shumë vjet me radhë. Tani të gjithë e kanë kuptuar se jemi skuadër serioze" ka deklaruar Shaqiri.

# Sa është i sigurt Botërori Rusia 2018?

MOSKË, 19 QERSHOR - Autoritetet e sigurisë në Rusi po ndërmarrin të gjitha masat që Kampionati të kalojë pa incidente. Por të shtunën që lamë pas ndodhi një rast që paralajmëron për rreziqet.

Një moment trishtues në Moskë. Një shofer taksie futet me makinën e tij të verdhë të shtunën e 16 qershorit, në afërsi të Sheshit të Kuq, në masën e njerëzve të mbledhur. Ai ka lënduar shtatë persona, ndër ta edhe tifozë të Meksikës. Shoferi ishte nga Kirgistani, një vend aziatik i banuar me shumicë myslimane. Shumëkush në Rusi kishte frikë se fjala ishte për një sulm terrorist.

Por vetëm pak më vonë erdhi shpjegimi nga kryetari i bashkisë në Moskë, Sergej Sobyanin. Shoferi i taksisë e ka humbur kontrollin ndaj makinës. Pra, fjala nuk ishte për një sulm terrorist. "Më vjen keq!", ka thënë shoferi.

Ai kishte dashur që pas një dite të lodhshme të shkonte në shtëpi, "për të fjetur". Duket se ka qenë i stërlodhur, kanë raportuar agjencitë ruse të lajmeve.

### Paralajmërimet nga sulmet

Por kjo ngjarje ka hapur debatin për sigurinë në vend. Ngjarja ka shkaktuar frikë tek organizatorët, politikanët dhe banorët e Rusisë dhe Moskës. Një javë më parë autoritetet amerikane kanë publikuar një paralajmërim për sulme të mundshme terroriste në Rusi. Rreziku më i madh është tek monumentet e rëndësishme, në trafik apo dhe vendet e tjera ku mblidhen shumë njerëz.

Në fillim të prillit të këtij viti në metronë e Shën Peterburgut ndodhi një sulm, ku një atentator vetëvrasës vrau 14 veta. Rreth 9 000 luftëtarë me nënshtetësi ruse janë duke luftuar në radhët e të ashtuquajturit Shteti Islamik apo në Lindjen e Mesme. Shumë prej tyre janë me origjinë nga Kaukazi Verior. Autoritetet ruse janë të vetëdijshme se në mesin e tyre mund të ketë edhe terroristë potencialë, të cilët duan të kryejnë sulme gjatë Kampionatit Botëror.



© picture-alliance/AP/D. Lovetsky

### Tifozët nuk kanë frikë

Me gjithë këto rreziqe, dhjetëra mijëra tifozë futbolli vazhdojnë të lëvizin në brendësi të Moskës dhe qyteteve të tjera, duke festuar fitoret e ekipeve të veta, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Në veçanti të zhurmshëm janë tifozët e Argjentinës, ndonëse ndeshja e parë e kombëtares së tyre përfundoi me rezultat dëshpërues (1:1) kundër Islandës.

Policia me uniforma mund të shihet gjithandej në qendër, por ka dhe shumë forca të sigurisë me veshje civile. Gjithandej në mure janë vënë edhe kamera sigurie, me sistemet për njohjen e fytyrave. Në afërsi të stadiumeve Lushniki und Spartak janë krijuar zona të posaçme të sigurisë. Banorët duhet të kenë leje të posaçme për lëvizje rreth shtëpive të tyre. Supermarketet dhe dyqanet e tjera nuk lejohen të shesin alkool gjatë apo pas ndeshjeve.

Policia nuk ka kurrfarë tolerance ndaj tifozëve që krijojnë incidente. Ajo është konsultuar me kohë edhe me autoritetet e vendeve të tjera që marrin pjesë në kampionat dhe ka kërkuar që tifozëve të dhunshëm të mos u jepen viza. Shtetasit e huaj gjithmonë duhet ta kenë me vete pasaportën. Ai që e ka harruar në hotel, mund të ketë probleme. Ndërsa në stadium mund të futesh vetëm me Fan-ID dhe biletë.

### Patrullat e rrepta

Rreth stadiumeve dhe në stadiume po patrullojnë dhe kontrollojnë forca të mëdha të policisë, ushtrisë, njësive speciale dhe gardës kombëtare (të ashtuquajturit Kozakët). Çantat kontrollohen gjithandej, ndërsa njerëzit filmohen me kamera sigurie. Ka të dhëna të ndryshme për forcat e angazhuara në Moskë, por ekspertët flasin për shumë më shumë se 100 000 forca të rendit dhe mbi 20 000 ndihmës vullnetarë. Ekspertët janë duke kontrolluar në sfond edhe rrjetet sociale. Telefonat e rasteve emergjente janë në funksion tërë kohën. Në Rusi kanë shkuar edhe ekspertë të sigurisë nga Gjermania, por ata nuk duan t'u përmendet emri. Ata janë duke bashkëpunuar me autoritetet ruse. Rusia po bën të pamundurën që Kampionati Botëror të kalojë pa probleme, thonë ekspertët. /DW/



## Botërori, shpresa e lojtarit korean për t'i shpëtuar shërbimit ushtarak



SOUL, 19 QERSHOR - Heung-min Son është ylli i Koresë së Jugut, por ai nuk ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, të cilit i nënshtrohet çdo shtetas në Korenë e Jugut deri në moshën 28-vjeçare. Të gjithë i nënshtrohen këtij rregulli, por në raste të rralla ka shtyrje apo edhe pezullim vendimesh. Son ka siguruar një shtyrje të ekzekutimit të vendimit deri në verën e vitit 2019 dhe shpreson se nëpërmjet justifikimit të "arritjeve të mëdha sportive" t'i anulohet plotësisht detyrimi për paraqitje.

## K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A. me seli ne Prizren

Ne bazë të Nenit 8 të Ligjit të punës Nr.03/L-212, Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" SH.A. Prizren , me datë 20.06.2018 shpall:

### RISHPALLJE E KONKURSIT

**Pozita e punës:** Inkasant, 1(një) në Njësin Punuese në Prizren
**Kompania:** Kompania Rajonale e Ujësjellësit " Hidroregjioni Jugor " SH.A. në Prizren
**Paga:** Koeficijenti sipas Rregullores së Kompanisë.

**Kushtet për punësim (edukimi i kërkuar)**

- Përgatitja shkollore: Shkolla e mesme adekuate
- Përvoja e punës: Se paku gjashtë muaj
- **Kushtet e veçanta:** Aftësi komunikuese, njohja e gjuhëve zyrtare dhe sjellja korrekte ndaj konsumatorëve

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

**Procedura e aplikimit:**

- Të jetë i aftë qe me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Bënë leximin e ujëmatësve në teren të ngarkuar më së paku 1 here në 2 muaj të njëjtin ujëmatës,
- Paraqet ujëmatësit e parregulltë,
- Bënë paraqitjen e kyçjeve ilegale,
- Paraqet kyçjet e reja dhe të pa paralajmëruara.,
- Paraqet pusetat e ujmatësave jo të rregullta,
- Ngarkohet me fatura për inkasim te harxhimit të ujit,
- Çdo dite dorëzon pazarin ditor,
- Obligohet që në rast të pamundësisë së pagimit të borxhit nga furnizuesi të dorëzoi vërejtjen mbi borxhin,
- Është i obliguar të mbaj mjetet mbrojtëse,
- Çdo ditë duhet të bëjë inkasim,
- Kryhen edhe punët tjera sipas urdhrit të udhëheqësit,
- Për punën që kryen i përgjigjet Shefit të inkasantëve.
-

**Procedura e aplikimit:**

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe se bashku me aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- Biografin (CV) e detajuar
- Letërnjoftim-kopje
- Letërmotivimi
- Diplomën e Shkolles mesme
- Deshmi mbi përvojen e sukseshme paraprake
- Deshmi që nuk është nën hetime

Aplikacionet mund të tërhiqen në zyrën të KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. rr."WESLY CLARK" pn.Prizren
Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorzohen në zyre të shërbimit për punë juridike dhe të përgjithshme të mbyllura në pako. Dokumentet nuk kthehen.

***Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimi respektivisht deri me datën 04.07.2018 në ora 16:00.***

K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" – Prizren

---

## UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
## FAKULTETI JURIDIK

Studimet Pasdiplomike të doktoraturës

Nr. 02/458
Prishtinë, 19.06.2018

Në bazë të nenit 127 al.1, të statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", nenit 17 al. 2 dhe 4, të rregullores mbi studimet shkencore pasdiplomike dhe Vendimit nr. 02/458, nga Mbledhja e Këshilli të Fakultetit Juridik, të datës 16.05.2018, si dhe vendimit për ratifikimin, nga Senati i UP, nr. 1/751, datë 19.06.2018, kandidatit Ma.sc. Flamur Hyseni, PhD.c, i është lejuar mbrojtja publike e disertacionit të doktoratës, andaj mbi bazën e dispozitave të më lartë cekura bëjmë këtë:

### N J O F T I M

Me të cilin njoftojmë të gjithë të interesuarit, se me datën 27/06/2018, me fillim në ora 11:00, në Amfiteatrin e vogël të Fakultetit Juridik të UP-së, kandidati për fitimin e titullit doktor i shkencave juridike, nga fusha: Kushtetuese – Administrative, Flamur Hyseni PhD.c, bën mbrojtjen publike të disertacionit me titull: "Ndikimi i procesit të integrimit evropian në sovranitetin shtetëror – analizë kushtetuese dhe krahasuese", para komisionit profesional, me këtë përbërje:

1. Prof.Dr.sc. Osman Ismaili (Kryetar)
2. Prof.Asoc. Dr.sc. Gjylieta Mushkolaj (anëtare)
3. Prof. Asoc. Dr.sc. Jeton Shasivari (anëtar i jashtëm, nga Fakulteti Juridik i UEJL, Tetovë)

Prishtinë, më 19.06.2018

Zyrtari i lartë për studime pasdiplomike:

___________________

/Ma.sc. Shaban Dulahu /

---

## K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A. me seli në Prizren

**Prema članu 8 zakona o radu Br.03/L-212 Regionalna Kompanija za Vodosnabdevanje "Hidroregjioni Jugor" D.D.Prizren, dana 20.06.2018 godine, objavljuje**

### PONOVNO OBJAVLJIVANJE KONKURSA

**Kompania:** R.K.V. "Hidroregjioni Jugor" D.D. Prizren
**Radno mesto:** **1(jedan)** Inkasant u jedinici Prizren
**Plata:** Koeficijent shodno Pravilniku Kompanije

**Uslovi za zapošljavanje (potrebno obrazovanje)**

- **Školska sprema:** Srednje obrazovanje,
- Radni iskustvo: Najmanje 6 meseci radnog iskustva
- Posebni uslovi: Komunikacijske sposobnostri, poznavanje sluzbenih jezika I korektno ponasanje prema korisnicima.

**Zadaci i odgovornosti:**

- Sposobnost obavljanja poslova sa punim radnim vremenom bez ogranicenja;
- Vrši čitanje vodomera na terenu sa kojima je zadužen najmanje 1 put meseeno;
- Prijavljuje neispravne vodomere;
- Vrši prijavljivanje neispravnih priključaka;
- Prijavljuje nove priključke koji su neprijavljeni;
- Prijavljuje neispravne šahte vodomera;
- Zadužuje se sa fakturama za inkasiranje potrošnje vode;
- Svakodnevno predaje dnevni Pazar;
- Obavezuje se da u slučaju nemogućnosti naplate duga od strane korisnika da dostavi opomenu o dugu;
- Obavezan je da nosi zaštitna sredstva ;
- Svakodnevno trudi se da vrši inkasiranje;
- Vrši i druge poslove po nalogu rukovodioca, i,
- Za svoj rad odgovara sefu inkasanata.
-

**Procedura aplikacije:**

Zainteresovani kandidati treba da popune aplikaciju Kompanije i zajedno sa aplikacijom da prilože sledeča dokumenta:

- Biografija(CV)detaljna
- Kopija lićne karte
- Motivaciono pismo
- Diplomu školske spreme–kopiju
- Dokaz o uspešnom iskustvu koje je predvideno
- Dokaz da nije pod istragom

Aplikacije mogu se podići u kancelariji u R.K.V."Hidroregjioni jugor" D.D., ul."Wesly Clark" b.b, Prizren.
Aplikacije i prateća dokumentacija treba se predati u kancelariji pravne službe zatvorene u koverti. Dokumenta se ne vracaju.
Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja i to do dana: 04.07.2018 do 16.00 časova.

R.K.V. "Hidroregjioni Jugor" D.D.Prizren

---

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Kontabilitet-D.L" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: Nrb. Biznesit: 810077380 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Kontabilitet-D.L." D.O.O odPristina, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : Nrb. Biznesit: 810077380 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Kontabilitet-D.L", D.O.O in Prishtina, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 810077380 The company has appointet a liquidator ësho is going to oversee the liquidator process. All clients ëho have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to shoë up ëithin 30 days starting from the day of neëspaper announcement- publication.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
***Ministria e Administratës Publike***
***Ministarstvo Javne Uprave-Ministry of Public Administration***

## KONKURS

Në bazë të Nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Nenit 8 të Rregullores Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike rishpall konkurs për këtë vend pune:

**Titulli i vendit të punës:**

I. **Drejtor në**:
Agjencinë e Kosovës për Akreditim/Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (1).

**Paga mujore:** 1.126.13 € bruto.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Siguron këshilla të politikave për Ministrin; siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të Agjencisë të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive; siguron që masat zbatuese të Agjencisë të monitorohen rregullisht dhe që të merren masa korrigjuese në rast të pengesave; menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit tjerë të Agjencisë; menaxhon financat dhe burimet e tjera të Agjencisë; menaxhon rrjedhën e informacionit në Agjencisë dhe koordinon raportet e Agjencisë me organet e tjera vartëse administrative etj.
- Përshkrimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësive të punës për ketë pozitë mund të gjeni në linkun **http://map.rks-gov.net/getattachment/2c956b17-b2ba-459f-8131-c240e190cfe3/.aspx**

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

- Në Shërbimin Civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar; janë në posedim të të drejtave civile dhe politike; kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative, që sipas ligjit kërkohen për pozitën përkatëse.

**Procedurat e konkurrimit:**

- Konkurrimi për pozitën e Drejtorit është i hapur dhe kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë nëpunësit civilë në pozita të larta drejtuese, pozita drejtuese ose në pozita të barasvlershme në institucionet e administratës publike apo në kompanitë publike ose private.

**Shkollimi i kërkuar:**

- Diplomë universitare (minimum 4 vjeçare pas shkollës së mesme) apo të avancuar, e preferuar në fushat që ndërlidhen me punën e Agjencisë përkatëse.

**Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

- Duhet të kenë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit; aftësi të larta organizative dhe drejtuese; aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negocimit; aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve; standarde të integritetit; ndershmërisë dhe drejtësisë; njohuri bazike në programet e kompjuterit.
- Së paku 8 vjet përvojë pune profesionale përfshirë së paku 5 vjet në nivelin drejtues pas diplomimit në universitet.
- Njohja e gjuhëve të huaja ka përparësi në rast të vlerësimit të barabartë të kandidatëve.
- Njoftohen aplikantët se pjesë e vlerësimit të përzgjedhjes do të jenë kriteret e hollësishme të paraqitura në përshkrimin e vendit të punës.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:**

- Përzgjedhja e Drejtorit bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

**Kohëzgjatja e emërimit:**

- Mandati për pozitën e Drejtorit është 3 vjet.

**Data e mbylljes së konkursit:**

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

**Paraqitja e kërkesave:**

- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Ministrinë e Administratës Publike, Zyra e Personelit, dhoma nr. 320, kati III , ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: http://map.ks-gov.net. **Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës; dëshminë për përvojën e punës; dëshminë se nuk është në hetime apo i dënuar për vepër penale (e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së këtij konkursi) dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.**
- **Aplikuesit duhet të paraqesin: 1) një CV; dhe 2) një letër motivim me shpjegime të qarta dhe shembuj nga përvoja profesionale që tregojnë se si përvoja dhe aftësitë e tyre përputhen me kërkesat e vendit të punës.**

***"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.***

***Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3, të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".***

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.
- Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin për verifikim dokumentet origjinale.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni znj. Sala Shala në tel: 038-20030620, prej orës 8:00 – 16:00.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
***Ministria e Administratës Publike***
***Ministarstvo Javne Uprave-Ministry of Public Administration***

## KONKURS

Na osnovu člana 15 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova i člana 8 Uredbe br. 06/2010 o Proceduri imenovanja u Visokim Upravnim Pozicija u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Javne Uprave ponovo objavljuje konkurs za sledeće radno mesto:

**Naziv radnog mesta:**

- Direktor u
- Agenciji Kosova za Akreditiranje /Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije (1).

**Mesečna Plata:** 1.126.13 € bruto.

**Zadaci i odgovornosti :**

- Obezbeđuje političke savete Ministru; obezbeđuje da političke odluke i druge mere Ministrastva sprovedu efikasno i efektivno; obezbeđuje da mere sprovođenja Ministarstva se redovno nadgledaju i da se preduzimaju neophodne mere za prevazilažavanje prepreka; upravlja civilnom službom i ostalim zaposlenima Agencije; upravlja financije i ostale izvore Agencije; upravlja tokom informacija u Agenciji i koordinira izveštaje Agencije sa ostalim nadležnim organima administracije itd.
- Kopmpletan opis radnih zadataka i odgovornosti za ovu poziciju možete naći na dole navedenom linku http://map.rks-gov.net/getattachment/911262db-0474-4480-859c-44d39fc38fa9/.aspx

**Uslovi učestvovanja regrutiranja su:**

- U Civilnoj službi, imaju pravo da se zapošljavaju svi državljani Republike Kosova koji su odraslog doba i koji imaju punu sposobnost delovanja; koji poseduju civilna i politička prava; koji poseduju neohodno obrazovanje i stručnu spremu za obavljanje ekzekutivnih zadataka, upravljanja ili sprovođenja administrativnih funkcija i da imaju fizičku sposobnost, koje su neophodne prema zakonu za dotičnu poziciju.

**Procedure konkursa:**

- Konkurs za poziciju Direktora je otvoren i pravo konkurisanja imaju civilni službenici koji su u visoko upravnim pozicijama, upravnim pozicijama ili pozicija koji su podjednaki u javnim ili privatnim kompanijama.

**Zahtevano obrazovanje:**

- Diploma univerziteta (minimum 4 godine nakon srednje škole) ili više, poželjna iz oblasti koja su nadovezana sa dotičnim poslovima Agencije.

**Sposobnosti, iskustvo i ostala svojstva koja se zahtevaju :**

- Potrebno je posedovati sposobnosti za određivanje i postizanje strateških objektiva institucije, kao i visoke sposobnosti organizovanja i upravljanja; odlične sposobnosti komuniciranja i sporazuma; dokazane sposobnosti za analiziranje stanja i predlog opcija; standarde integriteta, poštovanja i pravde; osnovno vladanje kompjuterskim programima.
- Najmanje 8 godine radnog iskustva u profesiji, uključujući najmanje 5 godina upravnog nivoa nakon diplomiranja.
- Poznavanje stranih jezika predstavlja prednost prilikom ravnopravnog vrednovanja kandidata.
- Obaveštavaju se aplikanti da će se vrednovanja bazirati na osnovu bližih detalja koji se nalaze u opisu radnog mesta.

**Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutiranje:**

- Izbor Direktora se vrši u skladu sa Zakonom br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova i Uredbe br. 06/2010 za Procedure Imenovanja u Visokim Upravnim Pozicijama Civilne Službe Republike Kosova i Uredbe br. 02/2010 za Procedure Regrutiranja u Civilnoj Službi.

**Trajanje mandata :**

- Mandat za poziciju Direktora je 3 godine.

**Datum zatvaranja konkursa:**

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja.

**Podnošenje zahteva:**

- Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Ministarstvu Javne Uprave, kancelarija Personela, br. 320, III sprat, zgrada bivšeg Doma Štampe, Priština ili preko elektronske adrese kroz: http://map.ks-gov.net. **U prilogu Aplikacije neophodno je da se dostave kopije dokumentacije o kvalifikaciji, za diplomirane u univerzitetima van zemlje treba da dostave dokaz o nostrificiranju diplome; dokaz radnog iskustva; dokaz da nije pod istragom ili kažnjavanjan za krivično delo (koja ne sme biti starija od datum proglasavanja ovog konkursa), i druge dokumentacije koja se zahtevaju za apliciranje za pomenuto radno mesto.**
- **Aplikanti treba da dostave: 1) jedan CV- u i 2) jednu pismo motivacije uz jasno objašnjenje i primere profesinalne iskustva koje pokazuje kako iskustvo i sposobnosti poklapaju sa zahtevima radnog mesta.**

***" Civilna Služba Kosova pruža ravnopravne mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i očekuje aplikacije od strane oba pola i članova svih zajednica na Kosovu.***

***Nevečinske Zajednice i njihovi pripadnici imaju jednako i proporcionalno pravo predstavljanja u organima Civilne Službe centralne i lokalne administracije, kao što je naglašeno članom 11, stav 3, Zakona br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova".***

- Zahtevi nakon određenog dana yatvaranja konkursa se neće ne primati. Ne kompletirana dokumentacija se također neće primati.
- U slučaju velikog broja prijema zahteva, kontaktiraće se samo kandidati koji su izabrani za uži krug. Kandidati koji su izabrani i pozvani na intervju, potrebno je sa sobom da donesu originalne dokumente radi verifikacije.

Za detaljne informacije, možete se obratiti gđi. Sala Shala br. tel: 038-20030620, između 08:00 – 16:00 časova svakog radnog dana.

trainkos

Hekurudhat e Kosovsës

**Fushë Kosovë**
**Data: 17.06.2018**

Kryeshefi Ekzekutiv në bazë të nenit 17 parag. 3, pika 1 e Statutit të HK-Trainkos Sh.A nr. 1/188, të datës 05.10.2015, në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, si dhe në bazë të nenit 4 të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MPMS) NR. 07/2017, shpall:

## KONKURS PËR PUNË DHE DETYRA SPECIFIKE

**Pozita: Konsulent i Jashtëm (Kohëzgjatja e kontratës 120 dite nga dita e nënshkrimit të kontratës)**

**Kushtet dhe përgjegjësitë kryesore:**

1. Ndihmon dhe jep këshilla ZKF-së në përgatitjen e planeve strategjike, planin investiv afatmesëm, përgatitjen e pasqyrave financiare dhe parashikimeve financiare, si dhe jep këshilla në përgjithësi sistemet e menaxhimit financiar të Kompanisë.
2. Ndihmon dhe këshillon ZKF-në të hartojnë një plan strategjik të qëndrueshmërisë dhe të përmirësimit të biznesit i cili duhet të jetë i detyrueshëm në praktikë dhe afatgjatë.
3. Përgjigjet në kërkesat për këshilla rreth raporteve të ndryshme financiare, administrative të kërkuara nga ZKF,si dhe jep interpretime të ndryshme sa herë që i kërkohet nga ZKF.
4. Kryen punë dhe detyra të tjera të përcaktuara nga Zyrtari Kryesor Financiar.

**Kualifikimet**

**Aftësia profesionale e aplikuesit**

1. Të ketë një arsim përkatës universitar në kontabilitet , administrimit të biznesit , financave , auditimit, ekonomisë dhe përvojë profesionale në kontabilitet /auditim. Të jetë i njohur me kërkesat e sistemeve moderne të menaxhimit financiar.
2. Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në fushat e lart përmendura në pikën 1.
3. Të jetë fleksibil dhe i gatshëm për t'u adaptuar me nevojat dhe kërkesat e ndërmarrjes.
4. Të ketë kreativitet dhe iniciativa për të ofruar ide të reja në lidhje me procesin e punës brenda Ndërmarrjes.
5. Të ketë aftësi për formulimin e strategjive financiare, raporteve financiare, politikave të kontabilitetit dhe procedurave të kontrollit të kontabilitetit, në përputhje me qëllimet dhe objektivat e ndërmarrjes, konform legjislacionit në fuqi.
6. Të ketë aftësi të mira të komunikimit në gjuhën shqipe dhe angleze.
7. Të ketë aftësi të mira të përdorimit të pajisjeve kompjuterike, në aplikacionet e MS Office dhe programeve apo softverëve të të dhënave tjera financiare.

**Procedura e aplikimit:** Kandidatët e interesuar të cilët aplikojnë për këtë vend të punës, duhet që t'i dërgojnë këto dokumente:
1. CV-në së bashku me foto, si dhe dëshmitë e përgatitjes shkollore – universitare.
2. Letër Motivuese.
3. Dëshmi mbi përvojën e punës në fushën përkatëse.
4. Certifikatat e trajnimeve eventuale.
5. Letër Rekomandime apo referenca eventuale (jo e domosdoshme).

Aplikacionin, konkursin si dhe përshkrimin për vendin e punës për këto pozitë mund t'i gjeni në www.trainkos.com, apo në ndërtesën e drejtorisë në Fushë Kosovë. Aplikacionin së bashku me dëshmitë tjera mund të dorëzohen në ndërtesën e drejtorisë së Trainkos SH.A. në adresën Sheshi i Lirisë nr. 22, në Fushë Kosovë. Dokumentet duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në të cilën duhet të shkruhet pozita që aplikon. Data e fundit për aplikim është më:**04.07.2018 ora 16:00.** Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

trainkos

Komisioni i Auditimit i HK Trainkos Sh.A, në mbështetje të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 si dhe duke pasur parasysh edhe Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike rishpall:

## KONKURS

**Pozita:** Zyrtar i Lartë i Auditimit të Brendshëm
**I përgjigjet:** Komisionit të Auditimit të HK-Trainkos Sh.A
**Lokacioni:** Fushë Kosovë

**Politika e Trainkos Sh.A:**
Trainkos Sh.A është i përkushtuar për krijimin e mundësive të barabarta të punësimit. Andaj, ne i ftojmë të gjithë të interesuarit e të dy gjinive, të të gjitha moshave dhe prejardhjeve etnike që të aplikojnë. Trainkos Sh.A është i përqendruar te tregu, ngritja e efikasitetit dhe zhvillimi në një kompani të qëndrueshme dhe të suksesshme në treg duke u bazuar në praktikat më të mira në biznes.

**Kushtet dhe kualifikimi i kërkuar:**
- Ekonomist i diplomuar.
- Të jetë ekspert i Certifikuar në Kontabilitetit apo Auditor i Certifikuar.
- Të ketë aftësi të komunikimit me gojë dhe shkrim në gjuhën shqipe dhe serbe, kurse preferohet njohja e gjuhës angleze.
- Të ketë pesë ose më shumë vjet përvojë pune në lëmin gjegjës.
- Të ketë njohuri mbi objektivat e auditimit të brendshëm, si dhe planifikimin, organizimin dhe teknikat e tij.
- Të ketë njohuri, mirëkuptim dhe aftësi për të interpretuar dhe zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për raportim financiar.
- Të ketë njohuri dhe mirëkuptim për planifikim afarist dhe strategjik, buxhet dhe kontroll të shpenzimeve.
- Të ketë njohuri për rreziqet afariste dhe kontroll të brendshëm. Aftësi për të dhënë siguri të pavarur dhe objektive për besueshmërinë e raporteve financiare, dhe përputhshmërinë e tyre me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- Të ketë aftësi për të analizuar dhe vlerësuar të gjitha proceset madhore në ndërmarrje në domenin e operativës (gjenerimin e të hyrave, shpenzimet operative dhe kapitale, prokurimin, personelin dhe pagat, menaxhimin e aseteve, etj) dhe domenin e menaxhimit (planifikim strategjik, buxhetim, planifikim afarist, raportim financiar, tatimor, menaxhues dhe rregullator, analizë dhe vendimmarrje, etj.) dhe të japë rekomandime specifike përkitazi me kontrollin e tyre të brendshëm.
- Të ketë aftësi për të kryer një vlerësim të pavarur të efikasitetit të politikave, procedurave dhe standardeve nëpërmes të cilave bëhet menaxhimi i resurseve financiare, fizike dhe teknologjike.
- Të ketë aftësi për të këshilluar menaxhmentin dhe bordin e drejtorëve të ndërmarrjes për rrugët dhe mjetet për të përmirësuar afarizmin e ndërmarrjes.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**
- Rregullisht të shqyrtojë gjendjen financiare të NP-së dhe kërkesat e saj të planifikuara financiare, si dhe t'i sigurojë Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;
- Rregullisht të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme (duke përfshirë ato financiare), si dhe t'i sigurojë Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;
- Rregullisht të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NP-së, duke përfshirë dokumentacionin financiar, mbahen në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me ligjin, dhe që projekt-deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt, dhe t'i sigurojë Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;
- Rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga NP-të të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe punëve të saj, dhe t'i sigurojë Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje ose sugjerime të cilat i konsideron të nevojshme;
- Të kryejë një vlerësim të pavarur të efikasitetit të politikave, procedurave dhe standardeve nëpërmes të cilave bëhet menaxhimi i resurseve financiare, fizike dhe informative.
- Të planifikojë, organizojë dhe mbikëqyrë punën e Zyrës se Auditimit të Brendshëm, duke përfshirë, planifikimin, hartimin dhe menaxhimin e programit për auditimin, organizimin dhe delegimin e punëve, dhe përllogaritjen e resurseve të nevojshme.
- Të përcaktojë llojin dhe teknikën e auditimit të brendshëm që do të përdoret për secilin rast konkret, bazuar në ligjin pozitiv, praktikat më të mira, si dhe në njohuritë dhe përvojën profesionale.
- T'i raportojë Komisionit të Auditimit dhe menaxhmentit përkitazi me politikat, programet dhe aktivitetet e zyrës.
- Të koordinojë kornizat e auditimit me auditorët e jashtëm dhe të përkujdeset që palët jo vetëm të jenë në dijeni për punën e palës tjetër, por edhe t'u raportohet për fushat gjegjëse.
- Të monitorojë zbatimin e përgjigjes së menaxhmentit sikurse edhe zbatimin e të gjitha rekomandimeve të Komisionit të Auditimit.
- Të ekzekutojë shqyrtime apo punë që kërkohen nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, Kryeshefi Ekzekutiv dhe Drejtori Financiar, me kusht që shkurtimi apo punët e tilla të mos cenojnë pavarësinë, objektivitetin dhe funksionet e auditimit të brendshëm.
- Të demonstrojë integritet personal dhe profesional konform me misionin, vizionin dhe vlerat e ndërmarrjes.
- Të rekrutojë, trajnojë, mbikëqyrë dhe vlerësojë punonjësit e zyrës

**Procedura e aplikimit:**
Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me aplikacionin të bashkëngjisin edhe këto dokumente:
- Biografinë (CV) e detajuar.
- Letër motivimin
- Dëshmitë mbi përvojën profesionale të punës.
- Prezantim të shkurtër mbi idetë, objektivat dhe këndvështrimin e tij/saj për menaxhimin e suksesshëm të Zyrës së Auditimit të Brendshëm.

**Procedura e aplikimit:**
Aplikacioni dhe konkursi mund të merret në ndërtesën e drejtorisë në Fushë Kosovë apo në www.trainkos.com. Aplikacioni së bashku me dëshmitë tjera mund të dorëzohet në ndërtesën e drejtorisë së Trainkos, në adresën; Sheshi i Lirisë nr. 22, Fushë Kosovë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më **04.07.2018.** Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen. Për informata kontaktoni në tel.: 038 534 864.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada – Government*
Ministria e Shëndetëssisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteska Bolnička i Klinička Služba Kosova- Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
**Spitali i Përgjithshëm, General Hospital, Opšta Bolnica, Genel Hastane**
**"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA" - Prizren**

Nr. 8/14
Date 19.06.2018
Lenda: Anulim Konkursi

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik, Neni 6, pika 5.1:

Anulohet

Konkursi nr. 8/8 për pozitat Bachelor i Radiologjisë, konkursi nr. 8/9 për pozitat mjek specialist internist dhe konkursi nr. 8/10 mjek specialist internist – nefrolog – Njësia e Dializës – Rahovec.

Drejtor i Administratës
MSc. i Juridikut Melinda Çollaku

Gjej PUNË
• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi
Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:
- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë
facebook
www.facebook.com/gjejpuneshpejte

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Sengul Mazrek shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - Vlll SHF "Hagji Ymer Lutfi" Mamush

▶ Ajriz Bajra shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren

▶ Gojart Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe dipllomen SHMM "Luciano Motroni" Prizren.

▶ Ferat Kajtazi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Anton Çetta" Skenderaj.

▶ Florentin Dervishi shpall të pavlefshme deftesat e shkollës fillore "Shote Galica" Runik, Skenderaj.

▶ Lidon Behrami shpall të pavlefshme diplomën dhe deftesat e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda" Mitrovicë.

▶ Alush Ergini nga Prishtina, shpall të pavlefshme të gjitha dokumentet e identifikimit si dhe patent shoferin te leshuara nga MPB- Prishtinë.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
Prishtinë


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333